

Në ceremoninë e çmimeve letrare të Ministrisë së Kulturës, fituesi për romanin më të mirë për vitin 2018, u shpall Tom Kuka, dhe publiku mësoi më në fund se ky ishte pseudonimi i gazetarit të mirënjohur Enkel Demi. Po përse i duhej t'i botonte jo me emrin e tij tre romanet: "Hide mbi kalldrëm", "Gurët e vetmisë" dhe "Ora e ligë", të cilët kanë dalë në një periudhë relativisht të shkurtër, çka lënë të kuptohet se janë mbajtur ndoshta në sirtar për një farë kohe? Qëkur ka nisur të shkruajë, cila është tematika e librave të tij? Autori në një bisedë me kryeredaktorin e gazetës u jep përgjigje edhe pyetjeve të tjera me interes për lexuesin e tij.

ENKEL DEMI (Tom Kuka) Kam çmitizuar heronjtë e përrallave, urtinë e pleqve dhe kam shkruar historinë e rrënjëve të mia


Frika më e madhe ka qenë që personaliteti televiziv i krijuar do e merrte në qafë shkrimtarin. Në përgjithësi televizioni është një truk, i cili më së shumti krijon një qasje të gabuar për personin që na del në televizor. Në një vend si Shqipëria gjysma e njerëzisë të duan dhe gjysma tjetër të urren, ndaj Enkel Demi në këtë këndvështrim nuk ka si përbën përjashtim.

SHKRIMTARI DHE FJALORI

nga Mira Meksi

Në nëntor të vitit 2019 u vu në qarkullim nga botimet "Bota shqiptare" fjalori frazeologjik anglisht-shqip i prof.dr Eshref Ymerit, i cili mban kaluar 25 mijë shprehje frazeologjike. Kushdo që merret sadopak me gjuhësi, apo është thjesht një lexues i mirë, e kupton se bëhet fjalë për një vepër nga më madhoret në këtë lami, nga ato që kërkojnë për t'u hartuar domosdo një dituri të jashtëzakonshme të fushës, një përvojë të shumëgjatë dhe po aq të jashtëzakonshme sa dituria, një vullnet titanësh dhe një jetë pothuaj asketësh.

(Vijon në fq.6)



(fq. 2)

KADAREJA ANTITOTALITARIAN

nga Arben Veselaj



(fq. 5)

Temën e madhe të letërsisë - opozicionin mes shtetit dhe individit, apo më ekzaktësisht marrëdhënien shkrimtari - diktatura, Ismail Kadare e ka trajtuar në shumë vepra të tij, por libri i fundit "Kur sunduesit grinden", siç duket, ia ka dhënë vulën këtij opusi. As krejt tregim, as krejt ese, as krejt roman, por një meditim krejt i veçantë letrar, ky libër është një shkrirje midis gjinive letrare, i cili na shfaq një botë ku zhvillohet lufta e lashtë midis dy të kundërtave...

Mbi historinë e palexuar dhe të ndryshuar të shtypshkronjës kineze dhe koreane me shkronja të lëvizshme

PRA, NË TË VËRTETË, NUK QENKA GUTENBERGU
AI QË SHPIKU SHTYPSHKRONJËN

(fq. 14)

Më 14.02.1984 ndërroi jetë fotografi i madh shqiptaro-amerikan



GJON MILI
njeriu kurth...

nga Besim Fusha

(fq. 10)



PËRSE
TOLSTOI
E URRENTE
SEKSIN?

nga Aleksandra Guzeva
(Russia Beyond)

Predikues i moralitetit nga njera anë, admirues i zjarrtë i grave nga ana tjetër... Si mund të bashkoheshin të dyja të shkrimtari rus më pjellori në të gjitha kuptimet e fjalës?

(fq. 12)

MË MUNGON
PAS MESNATE
rrëfim nga
Andreas Dushi



“DËSHIRA E
PREMIERËS”

Cikël poetik nga
Iilir Shyta

(fq. 10)

Në ceremoninë e çmimeve letrare të Ministrisë së Kulturës, fituesi për romanin më të mirë për vitin 2018, u shpall Tom Kuka, dhe publiku mësoi më në fund se ky ishte pseudonimi i gazetarit të mirënjohur Enkel Demi. Po përse i duhej t'i botonte jo me emrin e tij tre romanet: "Hide mbi kalldrëm", "Gurët e vetmisë" dhe "Ora e ligë", të cilët kanë dalë në një periudhë relativisht të shkurtër, çka lënë të kuptohet se janë mbajtur ndoshta në sirtar për një farë kohe? Qëkur ka nisur të shkruajë, cila është tematika e librave të tij? Autori në një bisedë me kryeredaktorin e gazetës u jep përgjigje edhe pyetjeve të tjera, me interes për lexuesin e tij.

ENKEL DEMI (Tom Kuka)

Kam çmitizuar heronjtë e përrallave, urtinë e pleqve dhe kam shkruar historinë e rrënjëve të mia

Lexuesi tani e ka ndarë Tom Kukën autor, nga autori i porsadalë në dritë, Enkel Demi. Andaj edhe pyetja normale do të ishte: përse ju duhej ky pseudonim? Mos vallë nga që në këtë kohë disa kolegë tuaj kanë shkruar libra, duke patur televizionin ku punonin si mbështetje, ndërsa ju keni bërë të kundërtën qëllimisht? Apo thjesht snobizëm? Një "futje në skenë" nën drita të fuqishme prozhektorësh, e parapërgatitur me kujdes? Intrigim, joshje, mister? Apo frikë nga një gjykim hipokrit?

Frika më e madhe ka qenë që personaliteti televiziv i krijuar do e merrte në qafë shkrimtarin. Në përgjithësi televizioni është një truk, i cili më së shumti krijon një qasje të gabuar për personin që na del në televizor. Në një vend si Shqipëria gjysma e njerëzisë të duan dhe gjysma tjetër të urren, ndaj Enkel Demi në këtë këndvështrim nuk ka si përbën përjashtim.

Duke e konsideruar letërsinë si gjëja më e rëndësishme që kam bërë në jetë (pas fëmijëve) nuk dëshiroja që njerëzit të shkonin drejt letërsisë sime, qoftë dhe me paragjykimin më të vogël. Ndaj, zgjedha këtë udhë, i ndërgjegjshëm që televizioni më shumë të prish punë në këtë zeje se sa të ndreq.

Padyshim, rrugëtimi i disa kolegëve të mi gazetarë në letërsi më dha një shtysë edhe më të madhe për t'u fshehur pas një emër shkrimi që nuk ma kishte vënë nëna dhe baba, por e zgjedha vetë.

Nuk ka qenë një zgjedhje marketingu, as një mënyrë kalorsiake për të hyrë në sallonin e letërsisë shqiptare, pasi sido që të jetë kalorës atje ka pak, lexues akoma më pak.

Janë tre romane: "Hide mbi kalldrëm", "Gurët e vetmisë" dhe "Ora e ligë", të cilët janë botuar në një periudhë relativisht të shkurtër, çka lë të kuptohet se janë mbajtur ndoshta në sirtar për një farë kohe. Nëse është kështu, çfarë ka ndikuar në mëdyshjen tuaj për të komunikuar me lexuesin?

Të gjithë janë libra të shkruar në këto kohë që janë botuar, por në sirtar ka plot gjëra të tjera që i kam "dënuar" me mosbotim. Kam vonuar të rishfaqem, sepse po e them copë; kisha frikë mos nuk dija të shkruaja. Kam shpenzuar pothuaj 20 vjet që ta mund këtë drojë. Jam përpjekur dhe më parë të dalë sipër saj, por shpesh nguti për të mbyllur një libër, ndonjëherë kriza e zhvillimit të një subjekti, linje apo personazhi ishin ujitja më e madhe ndaj kësaj pasigurie, derisa dikur ia dola ta mund dhe u shfaq, ani se sërish kur ulem të punoj diçka më zë paniku se mos jam duke gatuar gjellën e rëndomtë të një mediokri.

Kjo mund të jetë një tjetër arsye që doja ta fshihja fillimisht fytyrën në lëkurën e tjetërkujt, në vend që të thoja: "Ja ku jam".


Të tre romanet tuaja e marrin temën nga e kaluara. Thuhet se rrëfimet për një kohë të kaluar janë shumë tërheqëse për lexuesin dhe e kanë të garantuar suksesin. Por janë edhe më të vështirët. Si lindën te ju idetë fillestare për secilin roman?

Unë e gjej muzën time, atëherë kur jam i singertë me atë që shkruaj. Suksesi dhe lexuesi në momentin që shkruaj janë ende mirazhe që nuk i shquaj dot. Unë shkruaj për t'i treguar vetes një histori që e njoh, e di dhe luaj me trillet e saj.

Ju thoni me të drejtë që është e shkuara, por për mua është kaq e gjallë sa ç'është e tashmja. Shpesh për të kuptuar vendin tim, ndodhitë e këtij fisi të marrë si janë shqiptarët na duhet të qëmtojmë sjelljen e gjyshërve. Këtë kam bërë; kam shkuar të shohë të parët e mi. I kam vizituar dhe i kam treguar, duke ua hequr mënjandë lavdinë që u vesh koha nganjëherë pa të drejtë. Kam çmitizuar heronjtë e përrallave, urtinë e pleqve dhe kam shkruar historinë e rrënjëve të mia.

Kam rrëfyer të njëjtën Shqipëri që rrëfejnë plot shkrimtarë të tjerë bashkëkohorë, por i kam vënë në pah bestytnitë e saj, profetët e rremë, zotat dhe paganizmin që e kemi të ngulur gjer në ashtë.

Romani juaj i parë "Hide mbi kalldrëm" është një thriller që zhvillohet e merr jetë në Tiranë e viteve tridhjetë. Një krim ndodh, i pasuar nga hetime që mbajnë një pjesë të mirë të rrëfimit. Personazhe historikë shfaqen në skenë. Gjithçka rrëfëhet me një gjuhë të pasur, është një përzierje e gjuhës normative, dialektore dhe zhargonit, nëpërmjet metodës së realizmit, që e përshkruan realitetin e kohës së romanit me detaje nga më të saktat, "crudo", gjer edhe ato imorale apo vulgare.





Por edhe nëpërmjet metodës së natyralizmit, në një kontekst psikologjik, sidomos duke analizuar psikën e shtresave të ulëta, apo të shëgertit-punëtor seksi . Sa jeni konsultuar me dokumenta për të shkruar këtë roman? Sa kohë ju ka marrë shkrimi i tij?

Ky është romani që më ka marrë më shumë kohë. Unë vija nga një periudhë intensive leximesh të shtypit, publicistikës, historisë, letërsisë së viteve '30. Isha përthithur aq shumë në ato vite, sa pata nisur të jetoja në to.

Gjendesha në një shesh të Lisbonës ulur poshtë një statuje dhe shihja njerëzinë që sillej rrotull meje. Kisha oqeanin përballë dhe nuk e di përse mendja ime fluturonte në Tiranë. Asgjë nuk gjeja atje që të më çonte në vendlindjen time, por atje pashë skenën e parë të librit. Di Himën që duhet të linte të dashurën e zemrës dhe të çelte derën e shtëpisë që binte me furi.

Aty nisi kjo histori, por që më shumë se sa thriller ka për qëllim të tregojë qytetin, sepse

kërkon të thotë që asgjë nuk ka ndryshuar. Janë të njëjtat vese, të njëjtët njerëz të pamëshirë që shesin e blejnë çdo gjë, që kanë një etje të pamatë për të fituar para, për të ushtruar pushtet për t'i bërë dëm tjetrit.

Nëse sot jetojmë në një vend cubash, etërit i kemi patur cuba, prandaj nuk ka pse të habitemi.

Dy romanet që pasojnë ndryshojnë tablo si në metodë, në gjuhë dhe tematikë. Në romanin "Gurët e vetmisë", ndonëse nuk jepet e përcaktuar gjeografikisht skena e ngjarjeve, e cila mund të ishte dhe e gjithë bota, lexuesi e njeh menjëherë Çamërinë dhe tragjedinë e saj. Lënda e tij është histori, legjenda, përralla, gojëdhana. Gjuha është shumë e pasur, më së shumti dialektore, toskërishtja, çamërishtja. Aq sa e keni pajisur romanin me një "glosario", një fjalorth shpjegues. Si e morët në sy të përdornit gjuhën dialektore? Nuk kishit frikë se mos e humbisnit lexuesin? Në fund të fundit, ajo që e bashkon shkrimtarin me lexuesin e vendit të tij, është gjuha normative.

Unë jam rritur me këtë të folme. Për mua është muzikë. Nana ime ma flet ende sot e kësaj dite, por unë vetë nuk e ngas dot aq bukur sa ajo, ndaj thashë po e shkruaj. Përderisa mua më rri pas shtatit, e kuptoj dhe e shijoj, fëmijëve të mi po ashtu, përse nuk do e pëlqejnë të tjerët?

Ndaj nuk kisha pikën e dyshimit që po shkruaja një libër me gjuhën e dikurshme të të parëve të mi, në të cilën ata rrëfenin shumë bukur përrallat, mitet, legjendat, thurnin këngët apo hidhnin vallet. Besova tek ta dhe tregova si ata.

Buzë lumit Kalama me gjasë qëndronte Homeri, Orakulli i Dodonës, mbajta frymën edhe vetë.


Romani juaj i tretë është "Ora e ligë", një himn për dashurinë, i shkruar në frymën e romanit të dytë, me po atë gjuhë, me të njëjtën forcë simbolesh dhe metaforash nga më të arrirat në shtratin e padiskutueshëm të realizmit magjik. Në ndryshim me të dytin, ky roman i vendos ngjarjet në Çamëri, ka si prelud një personazh të folklorit çam dhe një toponimi të pasur të atyre viseve. Dihet që ju nuk keni jetuar në Çamëri, doket dhe zakonet dhe mendësinë e saj i njihni kryesisht nga familja, nga nëna juaj. Si punoni me Kujtesën mëmësore? Si e vilni aq suksesshëm gjuhën e saj? Si punoni ju vetë me atë gjuhë magjike që rrallë gjendet në letrat shqipe? Sepse një nga pikat e forta të shkrimit tuaj është gjuha.

Qysh i vogël ulesha në pëqi të tim eti dhe dëgjoja. Zija një qoshe dhe dëgjoja. Ndiqja si silleshin burrat, si e mbanin nderin në një tryezë rakije, si u vinin gratë pas fijos, si grindeshin, si dashuroheshin, si i vinin në ndihmë sho-shoqit.

Përherë në shtëpinë time biseda niste me Filan Fistekun, të birin e këtij e atij, nga dera e këtij dhe atij që shkonte diku e bënte diçka. Ata edhe kur venin të blinin shpezët që do i therrnin për festë dukej sikur hynin e dilnin nga një legjendë.

Ky raport i tyre me të mbinatyrshmen, me kohën, me vdekjen, me mënyrën si linin porosi për botën e përtejme më bën të shkruaj pa harruar fjalë, pa më shpëtuar qoftë dhe një hollësi.

Ata burra të lartë, me zëra të pjekur nga kafeja, rakija dhe duhani nuk kishin drojë të dashuronin dhe të rrëfenin çfarë ndjenin. Një i moçëm fort,



gati shekullor i shkroi letër të shoqes, sepse shkoi në një udhëtim sipas tij të largët, deri në Durrës. Dhe në fund të letrës i thoshte se do e puthte në gluhë, meqë në faqe dhe buzë e puthnin fëmila.

Më fal, por si mund të rrish pa shkruar një roman dashurie për këta?

Si punoni ju? Së pari si proces shkrimi: i vendosni veprës titullin që në krye të herës? E ndërtoni që më parë të mendje apo skicime strukturën narrative? E njihni pra rrjedhën e ngjarjeve që kur hidhni në kompjuter frazën nistore? Po personazhet si i krijoni? Jeni Zoti i tyre absolut, keni në dorë tërë fjetet e jetës së tyre brenda shkrimit, apo janë ata shpesh zotët e jetës që kanë? A ju merr kohë fraza nistore? Po ajo përmbyllëse? I ktheheni shpesh shkrimit për përmirësuar, apo shkruani me kujdes dhe merrni kohë, për të mos iu kthyer më?

Në çastin që jam ulur në kompjuter unë di në vija të trasha subjektin, personazhet kryesorë dhe linjat, por e papritura e shkrimit është sak këtu, sepse sipas meje procesi i shkrimit është një proces shndërrimi. Metamorfoza që pëson aksh linjë apo një personazh është e çuditshme, pasi ti je sundimtari i veprës, por ata të shpëtojnë, përherë janë në kryengritje dhe ka gjasa që të ta marrin pushtetin.

Kështu i lodhur, i munduar, shpesh i mundur shkoj deri në fund, prandaj përherë më ka qëlluar që pasi romani është mbyllur kam shtuar të tjerë kapituj, të tjerë personazhe, derisa rrëfimin e kam zotëruar me të njëjtën siguri si e kisha në krye.

Kur shkruani? Keni një kohë të parapëlqyer? Një klimë të caktuar që ju dikton e shkruara? Dëgjoni muzikë? Ju nevojitet qetësi absolute? A keni konfidetë tuaj letrarë, ata që e lexojnë të parët veprën e mbaruar? Po ata të tjerët, të cilëve keni nevojë t'ua tregoni paraprakisht, sepse kjo ju ndihmon për zhvillimin e saj gjatë shkrimit? Po nga ata që e ndjekin fletë pas flete shkrimin?

-Kur shkruaj jam murg. Shkruaj paradite zakonisht, por edhe pasdite. Mbrëmjeve shumë rrallë. Dëshiroj të jem vetëm, pa njerëz që kam afër. Në përgjithësi mbyllem në zyrë që në ato kohë kthehet në një farë qele.

Nuk para diskutoj me kënd për atë që shkruaj. Në fund mund të kem nevojë për një sy tjetër, pra për një ose dy lexues besimi.

Më pas e dorëzoj në shtëpinë botuese dhe jam qingji më i urtë i redaktorit. Punoj me të intesivisht dhe zbatoj porositë e redaktore me saktë si një shkollor i mirë.

Mendoj që një libër i mirë fiton një rëndësi të dorës së parë, nëse ka një shtëpi botuese të mirë.

Edhe diçka tjetër; nuk lexoj dot, kur jam duke shkruar. Jam i shpërqendruar në lexim, por më keq akoma në shkrim. Kështu, që kur shkruaj kam një aleancë të fortë me paditurinë.

Keni famën e një leximtari të madh. Cilët janë shkrimtarët e mëdhenj të botës që kanë ndikuar te ju? Po të gjuhës shqipe? Cilin shkrimtar ndieni më pranë natyrës së shkrimësisë suaj?

Jam një lexues si gjithë të tjerët, por meqë dal në televizor ndoshta evidentoj më shumë këtë anë, thua se po bëj ndonjë çudi që lexoj.

Unë lexoj çdo gjë dhe pa rregull; letërsi klasike, libra të verdhë, letërsi historike, kronika, francezë, gjermanë, amerikanë, rusë,



magjike, realistë, bashkëkohorë, absurdë apo ekzistencialistë.

Kur lexoj një libër të bukur jam i lumtur, sepse jam pjesë e kësaj historie. Besoj se leximi është proces krijimi. Ashtu si e lexoj unë një libër, nuk e lexon tjetër kush. Unë e shoh rrëfimin e shkrimtarit në bazë të fantazisë sime, krijoj në rreshtat e tij pamjen e personazheve, rrugëve, katundeve apo qyteteve. I bëj të gjitha vetë dhe kjo ta bën leximin një proces të papërsëritshëm, të mrekullueshëm.

Nuk kam një shkrimtar që ta gjej afër vetes, por kam shkrimtarë shqiptarë që kanë ndikuar me gjithë mend tek Tom Kuka. Dhe ata janë shkrimtarë paarritshëm, të cilët po i rreshtova do bija në një përsëritje të rëndomtë që e thonë të tërë.

Jam i zoti të udhëtoj me ta nga "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" tek "Vjeshta e Xheladin beut", më tej "Lahuta e Malcis" drejt e tek "Historia e njenës nga ato" e kështu me radhë, derisa shkoj tek

"Autoportret në teleskop" apo "Diktatori në kryq", ku pak më larg gjenden "Kronikat e mjegullës".

Heminguej thotë diku se të jesh gazetar, kjo të ndihmon si shkrimtar, me kusht që të largohesh në kohën e duhur. Keni ndërmend t'i kushtoheni krejtësisht letërsisë dhe të largoheni nga gazetaria?

Nuk e kam ndër mend; e kam bindje. Përditshmëria, nevoja për të jetuar dinjitetshëm dhe mbështetja që më duhet t'i jap familjes më mban ende në këto ujëra. Por, dikur do rifitoj lirinë dhe do i lë të tëra që të ndjek fatin tim në letërsi.

Kureshtia e lexuesit na bën t'ju pyesim se çfarë keni në dorë tani?

Është ende shpejt për të folur, por jam nisur për Shkodër.

KADAREJA ANTITOTALITARIAN

nga Arben Veselaj



Brenda letërsisë së Kadaresë, ashtu siç ka një korpus të "romaneve osmane" ka dhe një korpus "sovjetik", nga i cili kanë dalë shumë vepra që japin mesazhe të fuqishme përtej kufijve kohorë. E, brenda korpusit "sovjetik" libri më i ri "Kur sunduesit grinden", pa dyshim se do të radhitet në Panteonin e kryeveprave të letërsisë antitotalitare.

Temën e madhe të letërsisë - opozicionin mes shtetit dhe individit, apo më ekzaktesisht marrëdhënien shkrimtari - diktatura, Ismail Kadare e ka trajtuar në shumë vepra të tij, por libri i fundit "Kur sunduesit grinden", siç duket, ia ka dhënë vulën këtij opusi. As krejt tregim, as krejt ese, as krejt roman, por një meditim krejt i veçantë letrar, ky libër është një shkrirje midis gjinish letrare, i cili na shfaq një botë ku zhvillohet lufta e lashtë midis dy të kundërtave: lavdisë së shkrimtarëve, në njërin anë, dhe mizorisë së diktatorëve, në anën tjetër. Kjo "sprövë" më e re e Kadaresë duket se i ka vënë në dilema edhe vet studiuesit e letërsisë pasi që ata nuk po arrijnë dot ta klasifikojnë dhe ta krahasojnë këtë vepër me asnjë model pararendës, jo vetëm në letrat shqipe.

Vepra ngjan me një tregim hetuesie, por mund të lexohet edhe si biografi letrare; është sa përsiatje eseistike, po aq edhe një kronikë publicistike. Tek kjo vepër, si rrallë tek ndonjë tjetër, Kadareja na shfaqet me narracionin e tij të famshëm - *alla kadareançe*, kur linja rrëfimore e autorit-narrator dhe ajo e një rrëfimtari të dytë në sfond (të padukshmit, rrëfimtari empirik), shkrihet në një dhe na jep një prozë unike letrare.

"Kur sunduesit grinden" (me nëntitullin "Rreth misterit të telefonimit Stalin-Pastërnak") më së shumti përafrohet me tregimin "Ikja e Shtërgut" (1986) nga po ky autor. Njëjtë sikurse Pastërnakun tek "Kur sunduesit grinden", edhe tek tregimi "Ikja e Shtërgut" Kadareja sikur dëshiron ta ringjallë së vdekurish figurën përtjekohore të shkrimtarit të mohuar - në rastin e dytë të poetit shqiptar, Lasgush Poradeci. Kadareja na shfaq Lasgushin e pavdekshëm, në të perënduar të jetës së tij, klasikun e gjallë të letërsisë shqipe, të cilin doktrina letrare dhe politike e realizmit socialist shqiptar e kishte nëpërkëmbur, duke e ekskomunikuar nga letërsia dhe lëçitur nga elita, si një relik të tepërt që vinte nga "bota e vjetër". Por ky ekskomunikim dhe kjo lëçitje nuk e zhbënin dot Lasgushin - përkundrazi,

ai na shfaqet në letërsinë e Kadaresë edhe më madhështor "në vetminë e fildishtë".

Me 13 versione rrëfimesh mbi njërin nga bisedat më të vështira të zhvilluara ndonjëherë mes një shkrimtari dhe një diktatori, ka bërë që Kadareja me veprën "Kur sunduesit grinden" t'i jap jo vetëm letërsisë shqipe por edhe asaj botërore një monument letrar me të cilin përjetësohet lavdia e shkrimtarëve të mëdhenj përball paranojës së sunduesve diktatorialë. "E vërteta historike" dhe "e vërteta letrare" mes autorit-narrator (Ismail Kadare) dhe subjektit letrar (Boris Pastërnakut) në këtë vepër, na jep trilerin më të saktë mbi ankthit e gjatë komunist. Ashtu si Boris Pastërnaku, i cili s'kishte pranuar (guxuar) ta qaste nderimin që ia bënte bota Perëndimore më 1958 me çmimin Nobël (më 1958 shkrimtari frëng, Albert Camus e nominoi Boris Pastërnakun për çmimin Nobel, por nga presionet e komunistëve sovjetikë ai refuzoi ta merrte atë), ashtu edhe Ismail Kadare, siç duket, e ka vuajtur shumë gjatë ankthin e të qenit shkrimtar botëror në Shqipërinë e kohës izolacionizmit komunist.

Në pikun e regjimit të famëkeqit Stalin, Boris Pastërnak konsiderohej poeti më i madh sovjetik. Autor i disa veprave me poezi të cilat u thurnin himne komunistëve, askush nuk do të besonte se një ditë ai do ta shkruante një roman që synonte rrënimin e rendit komunist. Pastërnaku shkroi romanin problematik "Doktor Zhivago" i cili me tone epike e autobiografike flet për mjekun-poet, ish-aristokrat, Yuri Zhivagon, jeta e të cilit shkatërrohet në kohën e Revolucionit Socialist. Meju Zhivago është *alter-egoja* (vetja e dytë) e Pastërnakut. Ashtu si personazhi, edhe vet autori i tij, ishin viktimë të regjimit komunist sovjetik, që kishte përmbysur gjithçka nga shkëlqimi i vjetër rus.

Por, në veprën e Kadaresë "Kur sunduesit grinden" nuk është subjekt kryevepra e Pastërnakut "Doktor Zhivago" - është telefonata që atij ia bëri Stalini në vitin e vështirë 1934, për ta komentuar arrestimin e mikut të tij poet, Osip Mandelshtam, për shkak të një poezie satirike ku përgojohej Stalini si "maloku i Kremlinit".

Udhëheqësi i proletariatit botëror e kishte telefonuar Pastërnakun për ta pyetur se ç'mendim kishte për Mandelshtamin. Kurrë nuk ishte kuptuar se si i ishte përgjigjur Pastërnaku Stalinit për mikun e tij, por ajo që u kuptua - sot a atëherë, është se Stalini, në fund të fundit, nuk këmbëngulte në burgosjen as të Mandelshtamit e as të Pastërnakut, por në poshtërimin e tyre. Ai s'e duronte lavdinë e shkrimtarëve, andaj synonte t'i nxiste ata në një luftë paranojash e pabesish, ashtu siç bënte vetë me "shokët e Revolucionit", të cilët i vriste për çdo ditë.

Duke shtjelluar ankthin totalitarist në 13 versione, Kadareja pahetueshëm e shkanë lexuesin në ingranazhin e neveritshëm të mendimit kauzitar, të mendimit me unanimitet, të mendimit që privon individualitetin dhe spiritualitetin. Përgjigja e Pastërnakut: "Ne jemi ndryshe, shoku Stalin, Mandelshtami shkruan në një rrymë tjetër", si dhe kundërpërgjigja e menjëhershme e Stalinit: "Ti nuk qenka kurrfarë shoku, Pastërnak, ne bolshevikët e vjetër i mbronim shokët tanë", na jep tablonë mbi tjetërsimin e detyrueshëm të shpirtit njerëzor.

Kadareja, siç duket, e ka gjetur tek figura e Pastërnakut jo vetëm subjektin *anti-totalitarian* të letërsisë së tij, por edhe modelin jetësor e jetëshkrimor të shkrimtarit, nga pësimet e të cilit ai e ndërtoi vizionin për "bashkëjetesë" me diktaturën komuniste shqiptare.

KADARE

KUR SUNDUESIT GRINDEN

RRETH MISTERIT TË TELEFONIMIT
STALIN-PASTERNAK



Onufri

*Në dritën e botimit të Fjalorit frazeologjik anglisht-shqip të prof.dr Eshref Ymerit,
si një shërbestar i çmuar i gjuhës shqipe.*

SHKRIMTARI DHE FJALORI

ese
nga Mira Meksi

Shkrimtari dhe fjalori

Në nëntor të vitit 2019 u vu në qarkullim nga botimet “Bota shqiptare” fjalori frazeologjik anglisht-shqip i prof.dr Eshref Ymerit, i cili mban kaluar 25 mijë shprehje frazeologjike. Kushdo që merret sadopak me gjuhësi, apo është thjesht një lexues i mirë, e kupton se bëhet fjalë për një vepër nga më madhoret në këtë lami, nga ato që kërkojnë për t’u hartuar domosdo një dituri të jashtëzakonshme të fushës, një përvojë të shumëgjatë dhe po aq të jashtëzakonshme sa dituria, një vullnet titanësh dhe një jetë pothuaj asketësh. Sigurisht që autori i veprës i ka të gjitha këto cilësi, është një shkencëtar i mirënjohur në fushën e filologjisë, por edhe në atë të përkthimit.

Shërbimi që i ka bërë gjuhës shqipe, përpos asaj ndaj punëtorëve që operojnë me gjuhën, është nga më të çmuarit: ka qëmtuar, ka nxjerrë, ka vlerësuar, ka matur peshën dhe forcën që ruajnë në kohën e sotme njësitë frazeologjike, të cilat mbajnë të ngërthyer në thelbin e tyre tërë historinë kulturore të shqiptarëve, qytetërimit të tyre. U ka rënë fort këmbanave të hulumtive të tij, që jehona e tyre etimologjike të dëgjohet e qartë në kohën e sotme; në fund të fundit, i ka mbrojtur nga Harresa. Ka shkruar, gjithësesi, shumë më larg në punën e tij për t’i përshkruar, për të ndikuar dhe për të ndërhyrë në paraqitjen e tyre – ka dhënë raportin midis gjuhës shqipe dhe njërës prej gjuhëve më të rëndësishme të njerëzimit në ditët e sotme, asaj që e konsiderojnë si *lingua franca*, që ndikon te të gjitha gjuhët e botës, gjuhës angleze. Nëpërmjet njësive frazeologjike, fjalëve të urta apo proverbave. Nëpërmjet barabitjes së tyre, nëpërmjet gjetjes, shpesh të paimagjinueshme për nga saktësia, të barasvlerësve...

I mirënjohuri prof.dr Hajri Shehu, në parathënien që i ka bërë këtij Fjalori të jashtëzakonshëm me rreth 1300 faqe, mijëra njësi frazeologjike, fjalë të urta e proverba angleze dhe mijëra barasvlerës shqip, ka shpjeguar shumëçka, duke e ndihur mrekullisht përdoruesin e fjalorit apo thjesht lexuesin e tij, të kuptojë çdo hallkë dhe syth të thurimës së tij të pazakontë. Ka shkruar:

“Me këtë Fjalor, frazeologjia shqipe dhe leksikologjia shqipe barabiten denjësisht me frazeologjinë angleze dhe leksikografinë angleze”.

Kur flitet për një fjalor gjuhësor, apo një fjalor të veçantë frazeologjik, sidomos të këtyre përmasave, përmendet dobia e madhe që ai i sjell përkthyesve, studiuesve të gjuhës, deri edhe studentëve dhe askush nuk përmend shkrimtarin. E vërteta është se uniteti shkrimtar-fjalor është një simbiozë. Shkrimtari pi ujë në fjalor, ndërkohë që ky i fundit ushqehet me ujin e burimit të veprës së shkrimtarit.

Në botën e artit, përgjatë shekullit që lamë pas dhe shekullit të ri, përherë e më qartë po duket se detyra e shkrimtarit është të marrë pjesë në jetën e gjuhës. Ajo që e dallon nga pjesa tjetër e artit, që e bën të veçantë shkrimtarin, në një kohë kur ekziston përballë tij një konkurrencë e ashpër me televizionin dhe kinemanë përsa i përket ngjarjeve, personazheve, apo edhe pikëpamjeve mbi botën dhe shprehjes së ndjenjave, është pikërisht shkrimi, shkrimësia, puna e tij me gjuhën. Puna e tij vetiake me gjuhën dhe për gjuhën.

Nuk e kam fjalën këtu për ata shkrimtarë që e përdorin gjuhën thjesht si një mjet komunikimi, gjuhën për hir të gjuhës, për të rrëfyer histori a ngjarje. Këta mund të jenë gazetarë të zotë, skenaristë të mirë, apo edhe krijues trillerash interesantë. E kam fjalën për shkrimtarët që e përdorin gjuhën ndryshe. Për shkrimtarët që për hir të poetikës apo simbolikës, por edhe për hir të rrëfimit, narrativës, e zhbëjnë dhe e ribëjnë thurimën e gjuhës, e përpunojnë dhe e ripërdorin për nevojat e tyre krijuese, të detyruar apo nën presionin e asaj që duan të thonë dhe të shprehin. E kam fjalën për ata shkrimtarë që kanë si mjeshtëri krijimin e veprave origjinale të bazuara tërësisht te fjalët, enët e kuptimit. I kanë quajtur “rojtaret e jetës” së gjuhës, sepse janë pikërisht ata që ndodhen më pranë burimit të saj. Janë shkrimtarët ata që i përdorin fjalët duke patur parasysh dhe duke e shprehur, prejardhjen e tyre. Gjuha është e gjallë, është përherë në lëvizje, në ndryshim. Gjuha është *polemos*, luftë, thotë Herakliti. Fjalori, në një farë mënyre, mban dhe përfaqëson gjuhën, një pjesë të madhe të gjuhës, leksikon e saj. Që këtu buron edhe lidhja e shkrimtarit me fjalorin. Fjalori përmbledh edhe raportin e gjuhës që përfaqëson me gjuhët e tjera, me huazimet, përshkruan vlefshmërinë apo prestigjin e një fjale në kohë si edhe vendin e saj në aktualitet. Shkrimtari luan rol të veçantë në krah të specialistëve të gjuhës, në lidhje me gjuhën

dialektore përkundër gjuhës së normës (sot ka në letrat shqipe shkrimtarë që po përdorin me sukses gjuhën dialektore), neologjizme apo përzierjeve gjuhësore, të cilat e pasurojnë gjuhën.

Po le t’i kthehemi Fjalorit frazeologjik anglisht-shqip të prof.dr. Eshref Ymerit. Që kur nisa ta shfletoja përpara tre muajve, e “qava me lotë” mungesën e tij kohës së gjatë kur shkruaja romanin e vështirë “Mallkimi i priftëreshave të Ilirisë”. Romani në fjalë, përpos trillëzimit të mundimshëm që i bën ngjarjeve historike, por edhe personazheve që gjallojnë në to, aq të largëta në kohë, aq të padokumentuara e të humbura në mjegullinat e kohërave, sa që shpesh marrin trajtën e gojëdhanave, është ndërtuar si një bllok i tërë i bazuar në fjalët e një gjuhe që mund të përfytyrohet si shëmbëlltyra e shqipes parake, e protoshqipes, e paprekur nga ndikimet e gjuhës së pushtonjësve përgjatë dymijë e dyqind vjetëve. Njëkohshëm, një gjuhë brenda kohës së sotme, brenda normave gjuhësore. Një ndërmarrje fort e vështirë. Ndërkohë që Fjalori i sipërpërmendur, ku gjendet forma e brendshme e njësive frazeologjike, kuptimi i tyre etimologjik, si shpirti i gjuhës, i papërzier me kuptimin aktual, kuptimi konkret që i shpëton rrjedhës së pamëshirshme të kohës, do të kish qenë një instrument magjik në punën time.

Në poçarinë time të sotme me baltë krijuese ende të paformë: në të majtë kam përherë Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe, si një mik të rrallë që “më shpëton jetën”sa herë mbytem nga dyshimet, që më tregon kuptimin e vërtetë, kur idengulitje shpesh absurde “më helmojnë” ekzistencën, që më ndihmon të vërtetoj një intuitë, ta konkretizoj dhe ta zhvilloj gjatë procesit të shkrimësisë; që pasuron me ngjyresa kuptimore teksin tim të fillimit, për ta rafinuar dhe lartësuar...Si një autoritet i sigurtë. Është heroi im.

U bënë tre muaj që pranë dorës së djathtë mbaj Fjalorin frazeologjik anglisht-shqip të prof.dok. Eshref Ymerit. Iu avita atij së pari si lexuese, e rrëmbyer nga një pasion leximi i pavetëdijshëm, faqe pas faqeje. S’do ta kisha besuar kurrë se mund të lexoja kësisoj një fjalor. Për kënaqësinë e leximit. Më mrekulluan, veç të tjerash, edhe historitë e prejardhjes së njësive frazeologjike apo proverbave. Një enciklopedi e tërë. Me siguri s’do të ndalesha gjer në faqen e fundit, sikur ky proces të mos më bënte të ndalesha me dhjetra e dhjetra herë në shtyllat e gjuhës shqipe përbri njësive frazeologjike në anglisht dhe të përsiatësja gjatë. Shtyllat e shqipes përbënin fjalorë të vërtetë sinonimikë. Kishte raste që shtyllat kishin mbi 40 njësi. Një pasuri e vërtetë gjuhësore ndodhej aty. E mrekullueshme, e jashtëzakonshme. Një pasuri që më vinte në lidhje edhe me letërsinë e madhe të botës, me autorët e mëdhenj të gjuhës angleze, me vetveten dhe me intertekstualitetin. Admirova ditë pas dite gjuhën tonë! Përveçse shumë e lashtë, gjuha e Arbërit është tejet e pasur! E pasur sa gjuhët e mëdha të botës, të cilat lashtazi lëmonin vargjet e soneteve të tyre, kur shqipes i duhej të përleshej me dhëmbë e kthetra me zhbërësit e saj ndër shekuj, që të mbijetonte. Admirova zhvillimin e madh të frazeologjisë së shqipes, të letërsisë sonë, të kulturës sonë. Dhe njohjen e pafund të përpiluesit të Fjalorit, “gjuetarit të frazeologjisë”, njeriut të mijëra skedave gjuhësore që i ka gjurmuar, ndjekur dhe vjelë frazeologjitë, fjalët e urta, proverbat në mijëra e mijëra faqet e letërsisë së shkrimtarëve të gjuhës sonë.

Pasuria e madhe e frazeologjisë së gjuhës shqipe e ndryrë në këtë Fjalor rrezikonte të më merrte përnjëmend frymën. E ndjeva peshën e saj të madhe si trysni, kur iu avita si lexuese. Si shkrimtare gjeta aty një burim të madh frymëzimi, ushqimi, dinamizmi: lexoj sinonimet, zbuloj të panjohura, shijoj dhjetra e dhjetra shembuj, nuanca të holla, rizbuloj shpirtin e gjuhës, të historisë, dhe imazhe krijohen në përfytyrimin tim, ndjesi, aromëra...

Idë krijuese me rrënjë të thella në frazeologjinë e gjuhës sime marrin jetë. Dhe balta në poçarinë time të shkrimësisë zë e merr formë.





E HËNA E PARË E DHJETORIT

fragment romani

Ledion Krisafi



Mendimi se e hëna e parë e dhjetorit do të jetë me ngjashme me çdo të hënë paraardhëse përforcohet nga pamja që shfaqet përtej kangjellave të bardha ku jashtë në avlli, pikat e shiut, rënia e të cilave ka nisur mbrëmë në darkë a ndoshta një ditë më parë, përfundojnë ekzistencën e tyre të shkurtër mbi sipërfaqen e lëmuar të shkallëve lidhëse mes avllisë së poshtme dhe të sipërme pasi kanë prekur në rrugën e tyre tëposhtë degët e hardhisë ashtu si çdo të hënë qysh prej kohësh kur as e hëna e as unë nuk ishim. Mendimi se është koha për t'u ngritur, se poshtë në katoq nëna ka ngrohur qumështin, i ka hequr ajkën dhe ka hedhur brenda tre lugë sheqer, ka thekur bukën dhe ka shtruar gjalpin mbi të, aroma e të cilit përmëgjesshëm kalon përmes drasave të dyshemesë që ndajnë Odanë me katoqin poshtë për të arritur pranë dritares, te minderit nën të cilin flenë libra në gjuhë të huaja që kanë parë çdo të hënë me shi qysh prej kohës kur u hodhën nën minder për të mos u prekur më, tregime të Metodit e Konstandinit, i mëvonëquajtur Ciril të shkruara në po atë shkrim që ky i fundit i dha emrin, vërtitet shqetësueshëm brenda trurit në përpjekje për të detyruar gjymtyrët të hedhin tej ngrohtësinë e brendshme të jorganit dhe të përballen me ftohtësinë e një të hëne fillimdhjetori me shi.

Siguria se ngrohtësia e katoqit krijuar prej kaminetos vendosur në qoshen e kundërt me tavolinën e ngrënies krijon një prej kënaqësive kryesore të qenies pasi ke përshkuar hapësirën e ftohtë të njëzeteshtatë shkallëve që ndajnë kreun e Odasë me kthesën e djathtë në fund të shkallëve dhe derës së ljer me varak të katoqit është e pamjaftueshme, ashtu si nuk mjafton as kërkimi i arsyes së ngritjes prej shtratit tek aroma e tejkendshme e qumështit ajkëhequr e bukës së thekur e gjalpëlyer duke hedhur mënjanë jorganin ngjyrë kremi, marrë rrobat lënë në fund të minderit nga mbrëmja e djeshme e për të vazhduar më pas mbi kërcitjen e përçdohershme të dhogave të Odasë rrugën tëposhtë drejt katoqit për të takuar në qoshen e majtë të tij, mbi mbulesën ngjyrëvjollcë çafkën e qumështit dhe fetën e bukës, që duart, këmbët dhe gjithë masa trupore njerëzore të kryejnë veprimet e tyre të përmëgjesshme qysh prej kohës kur u shfaq për herë të parë mundësia e kryerjes së tyre e mendimi se asgjë nuk mund të shuajë dyshimin e përhershëm shfaqur çdo mëngjes mbi kuptimin e veprimeve të një të hëne fillimdhjetori me shi qenia e të cilave e ngjashme me ato të një të diele fillimdhjetori me shi e padyshimshëmrisht me ato të një të marte fillimdhjetori po aq mundësisht me shi, bën që zgjimi i mëngjesit e ngritja prej minderit të duken përditë e më shumë të pakuptimta aq sa pas një farë kohe dëshira për t'u ngritur e për të shijuar çdo

kënaqësi që ofron qenia zbehet e vyshket ashtu siç është zbehur e gjelbra e tavanit sipër meje ljer vetëm pak muaj më parë e siç do të kthehet në ndryshk e bardha e kangjellave. Poshtë në katoq, mëngjeset kafengrohta të shtatëdhjetë e tre viteve të tij nuk i kanë shërbyer për asgjë doktor Ashorvës, arkivoli i të cilit prej kohësh është gatitur, ushqimet e drekës pas varrimit janë porositur, të afërmit janë thirrur e toka pa dyshim është varrmihur e fjalët e Papos, thënë përditshmërisht porsa figura e vogël ashorvate kalon të kuqen e portës së jashtme e ngjit të hirtën e shkallëve lidhëse mes avllisë së poshtme dhe kafes së portës së brendshme, se doktor Ashorva është vdekjepritur, ashtu si ai vetë e të gjithë rreth tij, ashtu si e kuqja e portës së jashtme apo e hirta e shkallëve lidhëse, krijojnë një zgajtje mëngjesore largimi i së cilës prej duarve, këmbëve, dhe gjithë masës trupore duket po aq e vështirë sa dhe dëshifrimi i linearit A e ndoshta për shkak të kësaj qullësie mendore shtrirë mbi lëkurë, siç ndodh shpesh ta quajë i biri i Skëndulajve, aroma e qumështit, bukës e gjalpëlyer shndërrohet pritshëm në pjesë përbërëse të zgajtjes mëngjesore prej syve të së cilës gjithçka duket parëndësishmërisht e kotë e siç tregojnë rastet e njerëzve që nuk kanë asgjë për të bërë e shumë për të menduar pasi e vetmja mënyrë për t'i shpëtuar mendimit se asgjë nuk ka rëndësi është kryerja e diçkaje vetëvlerësuar të rëndësishme pasi vetëm në këtë mënyrë mund t'i shpëtohet tundimit për të dyshuar përmëgjesshëm kuptimin e përditshmërisë njerëzore, është se sa e vështirë është të gjendurit e një udhëdaljeje prej kësaj zgallome mendjezhapëse e gjymtyrëmpirëse.

Por, në momentin e parë, pamja përtej kangjellave, mbështjellë në ftohtësinë e një shiu dhjetorak dhe mendimi i së hënës që nuk ka përfunduar me mbrëmjen e djeshme e nuk do të mbarojë as me të sotmen, një mendim krejtësisht i pavetëdijshëm ky, ashtu siç janë pothuajse gjithë mendimet, përzierje e rastësishme e rretherrotullimshmërisë, në çastin e parë, krijojnë një ndjesi ngrohtësie edhe pse duart tashmë kanë dalë jashtë mbulesës për të lëvizuar njëgishtshëm vesën prej qelqit të dritares, një ngrohtësi prejardhur nga kënaqësia e mendimit që asgjë nuk ndryshon dhe asgjë nuk do të ndryshojë në të ardhmen, aq sa kangjellat, shiu jashtë tyre, vesa që ka mbështjellë qelqin e dritares dhe vetë minderit afër saj duket sikur krijojnë një botë të vogël, ashtu si një fëmijë trembur prej shtrëngatave futet poshtë mbulesave duke krijuar një botë të sigurtë ku qiellgjënimet nuk munden ta arrijnë, një botë brenda së cilës asgjë nuk ndryshon e asgjë nuk do të ndryshojë as në të ardhmen, gjyshërit poshtë në katoq nuk do të vdesin e vajzat nuk do të grunohen e brenda kësaj bote, mendimi i vdekjes është pothuajse i pamundur të lulëzojë pasi njeriu nuk mund të mendojë asgjë përtej asaj çka rrethon përditshmërinë e tij e nëse përmëgjesshmëria ime është një e hënë e ditëpërditshme kangjellash të bardha, shiu pikëmadh jashtë në oborr e vese të prasktë mbi qelqin e dritares, mendimi i vdekjes duket si një thermë në kraharor pasi ke kaluar një mbrëmje të bollshme ushqimi e pijesh e je ndier pothuajse i paprekshëm, pothuajse i pavdekshëm, ashtu siç ndihet njeriu zakonisht në momente kënaqësish të mëdha kur muret e kohës rrëzohen e jeta duket e gjithëherëshme, ashtu si njerëzit e lashtësisë mendonin se Gjithësia kishte qenë gjithmonë e do të ishte gjithmonë, pafundësisht, e mjafton një goditje në gjoks, pak rëndësi arsyeja e prejardhjes, për të të ndryshuar plotësisht nga të pavdekshëm në tërësisht të vdekshëm, madje pikërisht në ato moment, e dhimbja kalon prej gjoksit në shpatulla, në zverk e kënaqësia e pakmëparshme hopset krejtësisht e në gulçimin momentar jeta fillon të të duket një barrë që secili tërheq pas vetes rrugës për në varreza, e sa do të doje në ato çaste të fundeshe nën një mbështjellëse, kështu dhe mendimi i vdekjes në botën time të vogël është i vështirë për t'u gërxisur, duket pothuajse si një drà flugurosës në fund të kusisë së kënaqësisë së shiut qiellzymtues e vesës kesëdisëse të qelqit të dritares.



MË MUNGON PAS MESNATE

rrëfim nga

Andreas Dushi

1 am dhe më mungon

-Po bëhet më e thjeshtë? – Po, po bëhet! – Sa? Si? – Epo... Jo, të gënjeva. – Vitet... Po kalojnë vitet! – E ç'rëndësi ka? – Si s'paska rëndësi? – Dëgjo vetja ime! Nuk të lë të më tregosh çfarë ka rëndësi dhe çfarë jo! Asnjëherë nuk të kam lënë. Ndaj zhduku, ik, shporru!

U ula në gjunj para dritares. Dikur, përtej xhamit të saj shihnim bashkë agimet e mjegullta mes tymit të duhanit. Tani aty ka errësirë; dielli nuk është pluhurëzuar në miliona yje. – Mjaft e pe errësirën! Apo nuk do të më lësh të të them asgjë? – Po vetja ime, të më thuash ç'të bëj të lë, por jo të më tregosh rëndësinë e gjërave. – Më ndje pra për sa ndodhi... Tani lutu. Lutu!

I këndoi me harpë Zotit të mrekullive,

Zot, Zot! Po të lutem, Ty që je Zoti i mrekullive, mos i kurse mbi mua mrekullitë e tua. Jo, di çfarë? Mbi mua kurseji sa të duash, shtrëngoje grushtin e mos lejo grimcë mrekullie të dalë, nuk më intereson. Mbi të mos i kurse! E di se mrekullitë dalin si hire, prandaj po të lutem, fërkoji katër gishtat e dytë me gishtin e parë dhe lejo që prej aty të bien hiret tuaja. Ato le t'ja kthejnë asaj kokën drejt fistonit të ikjes. Dhe ta sjellin sërish tek unë. Amen!

2 am dhe më mungon

Nuk shpresoja të të harroja, por mendoja se do ja dilja mos të të kujtoja. Të paktën, jo çdo natë. Të paktën jo çdo orë. Por ja që nuk mundem dhe tani, nuk e di në e kam nga pagjumsia apo dhimbja, lotët braktisën shpellën e errët nën qepalla dhe ujësuan sytë. Më ka marrë malli për ty. Shumë më ka marrë malli.

Prej kohësh kam vendosur që kur të të kujtoj, t'ia hap mendjen pranisë tënde dhe ta shtie në njërin prej honeve të kujtesës. Duket se akoma nuk ke qenë në "Dëshira që ajo të jetë unë". Eja, hyr, pa frikë. Ka pak ujë, por nuk është i thellë. Do ta çekësh fundin pa problem. Mbërrite? Të lumtë!

Dhe kujtoi kur dëshiroi ta ndryshonte.

Ne ishim ndryshe. Ti pëlqeje ligjet, unë t'i theyeja ato. Prandaj gjithnjë redaktoje e para çfarë shkruaja! Gabova kur mendova se kjo do të të mjaftonte! Por edhe ti, pranove lehtë. Të më bindeshe mua e pastaj të më fajësoje për dështimet, të ngjau si zgjidhja më e thjeshtë. Unë doja të ishe unë, jo pse jam egoist. Jo, por sepse ti më bëre të besoja se unë jam më i miri. Doja që edhe ti të ishe më e mira. Të detyrova të bëje çfarë bëja unë? Po, e bëra. Sepse ti doje ta bëje. Doje

të ishe unë, të ishe njeriu që dashuroje a të paktën, si njeriu që dashuroje. E pe se nuk mundeshe dot. Më fajësove. Dhe ike.

Atëherë po, doja që ti të ishe unë, por tani gjithçka dua është që unë të jem ti. Kështu mund të kthehem dhe me ty, ta zhbëj braktisjen tënde.

3 am dhe më mungon

Duhet të mësohem me vetminë. Kam kuptuar se veli i saj i errët, më rri mirë. Ndaj, tani po e vesh. Jo pse ai më mban ngrohtë; e kam thënë kushedi sa herë se çdo vetmi është e ftohtë. Po e vesh ngase dua të udhëtoj me të. Le të nisem drejt skutave ku flë gjumi. Do ta zgjoj dhe ose do t'i zë vëndin, ose do t'i shtrihem ngjat.

Pastaj fluturoi lart drejt qiellit,

Me velin e vetmisë, pendëzi si korbat e natës, fluturova lart. Dikush më tha se gjumi flë në qiell. Është errësirë, por dielli i ikjes tënde ndriçon fort, aq fort! Pendët e velit shkrihen, Dedeali dhe Ikari s'janë veç personazhe të një miti, dhe unë bie sërish poshtë, në dhomën time dritare-çati ndërtuar mbi dheun e pagjumësisë.

Përkrah dhomës, shoh mes mureve se më pret një gropë e thellë diku deri në gju. Aty ndjej ngrohtësi kalljeje dhe asnjë drojë nuk më ndal dot. I jap hov hapit, bëj të nisem, por mendoj. Në fund të fundit, do të jetë trupi ai që, po qeshë me fat, do të vdesë. Shpirti jo! Ndaj jo, ndaloj dhe kthehem. Mallkoj botën, pse asaj i përkasim me trup e jo me shpirt!



4 am dhe më mungon

Pikat e ujit që stuhishëm puthin ajrin sa herë putrat e maçokut përplasen me pellgje në asfaltin e shtruar pa rregull, më tregojnë se nuk jam vetëm unë zgjuar. Dal të hedh një sy në sytë e tij të kuq. Ai më sheh, trembet dhe niset drejt murit. Rropatet gjatë ta ngjisë, thua se pas tij gjendet shpëtimi. Prit, mos vallë sytë e mi për të janë rreziku?

Zogj të ngordhur i ranë përsipër,

Mendoj murin tim, dëshirën për ta kaluar por gurët e tij janë ngjitur mes tyre me kujtime të lëngëta. Edhe maçoku, me murin e ka problemin. Veçse të një tjetër lloji: gurët e tij janë ngjitur me cicërima të ngordhura zogjsh krahëçalë. E zgjata shumë të menduarit, bëj mirë ta ndërpres. Ndoshta në një a ndonjë tjetër mënyrë, do ja dal të flë. Ku i dihet, pjella e natës dhe errësirës mund të vërë dorë mbi mua!

5 am dhe më mungon

Dëgjoj ninullat bërtitëse të sendeve që heshtin. Shishja e *Vechia* – s i këndon gotës së shkurtër, tavlla i këndon paketës së *Malboro* – s dhe ngadalë, gjithçka po më lë vetëm tek mbaron në gjumë. Por jo unë, vetëm unë nuk e lë veten vetëm edhe pse, sikurse u lexua edhe prej teje lexues që s'di pse të rrëfej kaq shumë nga vetja, nuk e dëgjoj për shumëçka.

Dhe ja hëngrën sytë,

Po filloj të mendoj mos ndoshta jam i mallkuar. Nuk ka asgjë të keqe, shumëkush është. Tani më duhet vetëm të gjej nga çka... ose prej kujt! Mos ndoshta koha? A mallkon koha? E ardhmja më ka mallkuar? Jo, e tashmja! Ç'them kështu, e tashmja është mallkimi! Ka qenë e shkuara. Po, ajo ka qenë mallkuesja! E shkuara më ngjante si lumturi. Dreq, gjithnjë gjithçka mbulohet nga velenxa që ndryjnë kundërshtitë e së fshehtës. Po, sepse e mbuluara e fshehtë është!

Kur ike ti, nga thellësitë e natës mbiu një trung në të cilin jam gozhduar. Rrotull tij nuk ka as mëngjes, as mesnatë; as agim, as muzg; as ditë, as natë; as dritë, as... Po! Errësirë ka! Edhe kur paskam qenë mallkuar, ka pasur. Edhe tash që jam i mallkuar, ka. Edhe kur të sosë mallkimi, do të ketë. Nëse do të sosë, sigurisht. Jo, për errësirën nuk ka farë rëndësie: si sosi si jo mallkimi, errësira do të jetë!

6 am dhe më mungon

"Gjithnjë e kam urryer botën deri kur ti u bëre bota ime!" kujtoj të të kem thënë kur mendja më thoshte se më dashuroje. Sepse ti ishe mendja ime, ndaj edhe ajo më gënjente lehtë. Tani që ti vijon të jesh bota ime, unë nuk mund të resht se dashuri atë edhe pse ajo nuk më ofron çka më së shumti dua prej saj: Ty!

Pra unë të mungoj, i mungoj botës. Ky mëngjes sërish është i zbrazët, arsyeja të zgjohem më mungon sa herë nuk kam pasur një gjumë nga i cili të mund ta bëj këtë veprim të mistershëm: zanafillë të ditëve që sado të mos duam, numërohen disi nga dikush.

Duke e mallkuar me zbrazëti që sheh!

Shoh rrotull. Thellë brenda meje, ngre krye një shpresë e marrë mos do të jetë diku. E urrej veten kur shpresoj! Por ajo erdhi si pasojë e një shprese se do të gjeja dikë që do të më mbështeste. Tani nuk e shpresoj diçka të tillë, shpresoj thjesht atë, edhe pse kurrë nuk përmbushi shpresën time. Fshehur ndër skajet e parëndësishme të gjithçkaje më mbështjell rri aroma e saj, ruajtur fort mirë në kujtesën e hundës. Çdo ditë, gjërat bëhen më të vështira. Dhe ajo vijon të ikë më larg, ndërsa unë e kërkoj më afër! Gjithsesi, diçka ndodhi sonte: Nga "Ti" u ktheve a u kthye në "Ajo".

14 shkurt i pa/çdo vit

Requiem për J...

Kambanat gjëmojnë papushim,
litarët e gjatë
akrobaci i bëjnë ajrit.
Organo luan requiem
Mesha filloi dhe mbaroi.
Hija e saj
është jashtë-brenda meje
si dikur.
Sa keq që të ëndërruarën puthje
Harruam!
Ti je larg,
shumë larg.
Kaptuar male, shtete, oqeanë...,
Ke marrë formë avioni.
Shkrihen zhurma, ajri... në një
e ti bëhesh kaltërsi
që syrin tim vret.
Tani je larg
vetja më është
gjymtim dhe mall,
dhimbje dhe shpresë.
Ti je larg dhe afër.
Afër dhe larg.
Dritësorja e fakultetit
ka vështirimin tënd.
Sytë e t'u zëvendësuar
kanë xhamat.
Në pritje të çdo vështirimi
dashuror,
cigaret digjen e tymojnë
aromë trupash
si atëherë.
Vetëm mimozat nuk duan
të ledhatojnë syrin e qelqtë,
ndaj anën time mbajnë.
Unë rri e vështroj statujshëm
etydin e malltë.
Verdhësia e pemëve
pikon hije të verdhtë,
si ajo llamba konviktores
netëve të vona,
errësirë i pikonte lakuriqësisë tonë
deri në çastin,
kur fshesaret fillonin të fshinin
rrugën e fatit,
e dashuria mbulohej
me pluhur malli,
si sot që je larg
kur e verdha hije,
hijezon trupin tim të mishtë
e duket sikur toka na mbledh
me perin e Arianës.
Fillin e hijes së diellit
dhe të verdhin fill të rrezes
pranë mimozës
shtërngojmë të dy.
Me pë në duar, sy...
fluturojmë avionësh
të fatit harraq
e mbase një ditë
mbrritja është
në aeroportin (oborr)
të fakultetit,
ku si zanë kreshnikësh
Ariana ndriçon
requiemin e dashurisë,
e na ruan edhe pse larg
njëri-tjetrit.
Me fillin e saj ndoshta
një ditë do ndezim
ëndrrën e dikurshme,
e flaka magjike
do kumbojë jo nota requiemit,
në festën e bashkimit!

“DËSHIRA E PREMIERËS”

Cikël poetik nga

Ilir Shyta

Bosh

Unë e ti pa dashuri.
Zemrat vet'mëvete
janë sy statujash
që shenjojnë
funeral lumturie.

Dëshira e premierës

Të kisha parë
s'më kishe parë,
e njëkohshëm përtypnim suksesin
dhe ngrinim flamuj
të buzëqeshur virtualë.
Bobina e metrazhit vijon të luajë
ende ekranizimin e Vitit të Mbrapshtë.
Fletët e librit të ri,
janë ftesë eksperience,
për të firmosur
llojin e përjetësisë
së gjithësecilit.
-Ku do ikësh tani?
-Në shtëpi, të thashë!
...dhe nata e kryeqytetit
errësoi si në fillimfilm
minutën tonë.
Nuk u ndamë si miq
që të takoheshim gjithë mall!
Ajo ishte një natë
e mrekullueshme
për në tejmiqësi...
Mbase ju ka ndodhur...?
E tillë është performanca
edhe këtëjmi Europës!
B. D., më pas u harrua në intervistat
e premierës...!
Njerëzit janë si yjet
nuk i sheh gjithmonë,
por e di se ekzistojnë
në shkëlqimin e tyre!
U shkrep një foto,
më saktë disa të tilla
që ti s'i refuzove në ballinë të Millennium-it.
Kishte diçka të përafërt
mes nesh,
në prezencën tënde
që i nevoitej simes.
Ajri i zbrazët
njëlloj si dashuria e ëndërrt
më krijoi boshësi,
në sallën e mbushur përplot.
Nga inati dua të thyej ekranin e gjerë
dhe ta puth Martën,
mu përballë spektatorëve
dhe vetë B. D.-së!

Nën çati

Vera e sivjetshme
vdiq mbi shtator.
Vera e buteve akoma jo!
...sepse është në gjakun tim.
E shenjtë,
e ëmbël dhe e hidhur,
gjithë trupin ma deh.
Dhe prapë
të pi të gjithën,
më pi të gjithin...
Plot pjalmim
errësira xhelozon nudizmin,
mes çarçafësh!


Mekanizmi i pijes

Gotë e parë për ty
e dyta...
e treta...
e katërta...
e pesta..., po për Ty!
I dehur shoh dy njerëz,
katër sy,
Shoh dy dashuri.
Brenda teje shikoj dy zemra
atë që më do
dhe tjetrën që s'më do...
Pija, është skaner
që esëll,
frikes ta ndërmendësh!

Kumbarës

(Ana Jovanit)

Mbrëmjes
jeton tej largësisë, mallin
kalëruar si Doruntinë.
Agut
pi gotën e diellit
e rrezaton për mua.



Ilir Shyta është pedagog
i Letërsisë Bashkëkohore
në Universitetin “Fan
Noli” të Korçës. Ka
botuar “...kur çmendej
Deal!” poezi 1997; “Trill
vjeshte” poezi 1999; “
E vërteta bën keq në
zemër!” sprovë letrare
2006; “Bibliografi e
arsyetuar për jetën
dhe veprën e Lasgush
Poradecit” Studim 2009

Më 14.02.1984 ndërroi jetë fotografi i madh shqiptaro-amerikan Gjon Mili
(1904-1984)

GJON MILI NJERIU KURTH...

nga Besim Fusha

...Mili nuk ju vret. Por, më zi se aq, ju zë të gjallë... Mili ju kap gjallë në gjendje të pagatuar... dhe ju përpëliteni në fotografinë e tij si peshku në rrjetë... Mili është njeriu kurth... - ka ca marifete... të ve në provë... simbas tij ka po aq mënyra për të dalë në fotografi, sa çka edhe njerëz... - tha Zhan Pol Sartri.

Gjon Mili – shqiptaro-amerikani, që, me artin e tij, ndjesoi Botën. Fotograf. “Shqiptari gjenial” – e quante dramaturgu irlandez Sean O’Casey. Dhe thënia niste Botën, duke e braktisur autorin. Mbase sepse, diçka përtej autorit, i adresojë vërtetë gjenitë që “kurthoi...” gjenitë: Pikaso, Matis, Sofia Loren... Sekondçaste domethënëse nga jeta e tyre. Përjetësimi. Dhe, madhështie figurative...

Prof. Dr. Safete Musa Juka (1921-2005) – (shqiptaria me vlera akademike në filozofi, art dhe letërsi franceze – lektore në Universitete me vlera – Profesoreshë në Harvard... - universitet që ka “prodhuar” 8 presidentë amerikanë dhe 40 fitues të çmimit “Nobel”. Ismail Kadare, e ka cilësuar si intelektualen më të madhe shqiptare...) – i shkruan një mikut dhe kolegu, Lec Shllaku, mbas vdekjes së Gjon Milit:

...Gjon Mili, mbas një udhëtimi në Rumani, pat botue, në LIFE Magazine, një artikull në lidhje me

familjen e vet. N’at artikull flit’te gjatë për nanën e ma shkurt për të jatin. Thonte kjashtas se e ama ishte shqiptare, përta i përket babës, nuk u kuptonte krejtë mirë prej tekstit në se edhe aj, si e ama, ishte shqiptar. Përfitova prej rastit, kur i shkrueva për ekspozitën... për me e pyet për këtë gjë. Gjon Mili m’u përgjegj pa vonesë tuej më thanë se nuk do të kishte dëshërue qi ndokush të kishte dyshim për origjinën shqiptare të babës së tij. Aj shtonte se, në fakt, si prindët e tij, ashtu edhe aj vetë, kishin lindë në Korçë.

Kur hapi një ekspozitë në Paris (1946), prezantuesi e quajti Xhon... Gjon Mili – korigjoi... - tha se diku në këtë Europë ndodhet edhe në Shqipëri... dhe shqipja e ka një Gj. – që më piknis emrin... Heshtje. Që përshpejtoi ta përzente Zhan-Pol Sartri: “... kjo që thotë Gjoni do duartrokitur!” Dhe, nisi i pari. Nisi edhe fjalën e famëshme që Gjon Mili e mbante brenda vehtes si një hajmali... Zhan-Pol Sartri i madh, tha:

Mili ka një kokë milingonangrënësi, një hundë që shkon t’i marrë erë botës shumë përpara tij, a thua se do ta zhysë papritmas në ndonjë fole milingonash, e pastaj, nën këtë hundë, shumë më prapa, ca mustaqe të vogla. Nga pjesa tjetër e fytyrës, sy, mollëza, flokë katrahurë, ai do të ngjante më fort me një cub malazez. Gjithsesi, është gjuetar dhe mishngrënësi. Nuk kisha njohur, para tij, veçse fotografë me gjak të shterpët, që fotografonin nga inati, ashtu siç vritet. Mili nuk ka inat; atij i pëlqen gjithçka: të hajë, të pijë, të

kërcejë; e njeh Harlemin më mirë se asnjë i bardhë, Nju Jorkun më mirë se askush. Ai është i lumtur. Nuk ka dëshirë t’ju vrasë. Puna është më zi se aq, do t’ju zërë të gjallë. Në portretet tuaja më të mira, ju jeni të vdekur të balsamosur, të kripur në hiposulfit, ashtu siç ju shndërron në brendësi më në fund përjetësia. Mili ju kap gjallë në gjendje të pagatuar dhe ju vazhdoni të përpëliteni në fotografinë e tij, si peshku në rrjetë, si puna e atij zhonglerit me cilindër të mëndafshhtë që vazhdon të bëjë trishtueshëm në atë pamje numrin e tij dhe topat e të cilit herë dalin nga lëvizja përgjysmë si prej një batakut, herë përlloçen në të, herë shkrihen krejt me të, apo si ato kërcimtare zezake që ai i ka futur në një kafaz e që hidhen më kot në tavan në përpjekje për të dalë andej, apo si ajo gruaja lakurige që ngjan si e parë me sytë shumëplanësh të mizave. Ai është një njeri-kurth dhe, për t’ju bërë të shkujdesur, ka ca marifete prestidigjitorit; ai nuk kënaqet që t’i kapë njerëzit e famshëm me aparatit e tij, por bën hall që çdo fotografi të jetë një vënie në provë: sipas tij, ka po aq mënyra për të dalë në fotografi sa ç’ka edhe njerëz. Po të bini brenda, jo vetëm që do t’ju ketë ngulur për së gjalli me gjilpëra me kokë në koleksionin e tij, por edhe do t’ju ketë vëzhguar, do t’ju ketë njohur: do t’i jeni dorëzuar dyfish. Popujt primitivë të Deteve të Jugut, siç tregohet, nuk lënë njeri që t’i fotografojë; u duket se po i robërojnë dhe se po ua rrëmbejnë timonin nga duart për jetë të jetëve. Shiheni fotografinë e Molotovit nga Mili dhe do ta kuptoni mençurinë e tyre.

Ka qenë messhkurti i vitit ‘84, kur mbarë Bota njoftonte vdekjen e Gjon Milit. (Bazuar në të shpejtën “The New York Times”). Shqiptarët këtu, të shurdhër e të heshtur... (Radiovalët që mund të çanin pengesat dëgjoheshin “hajdutshe”... e, po “hajdutshe”, ende zorshëm përshpërtej veshëve). Në të vërtetë lajmi e kapërceu praghyrjen e ATSH-së, por «Axhanset e verdha», ashtu të blinduara, rreptësisht adresoheshin vetëm për “Bllokun”. Unë e vola fletën lajmëse për Milin – por, kush më ndihmoi, kërkoi ngulshëm t’i kthehej se, “ashtu ishte puna...” Qenë ditët e një tensioni të jashtnatyrshëm, qetësiprishëse, të pandodhura në ASHSH, duhej arritur FESH (Fjalori Enciklopedik Shqiptar), thuhej pragveshëve se “xhaxhi” (E.H) qe sëmure dhe “t’ia bëjmë qefin në datëlindje...” (Madje shtohet me marifet se, kush pengonte mbante përgjegjësi penale). Ç’do të të mëngjesit mblidheshim për detyrat, në ca zyra kote, ashtu frymëngrirë, në godinën e akullit antike të Toptanasve. A.Papa guxoi për Nënë Terezën... Të shtohet ndër figurat. Dhe foli për të. Qe hera e parë që dëgjova se një shqiptar pat “habitur” Indi, zhuri Nobeli (1979) dhe njerëzimin mbarë...Unë mora vrull dhe propozova Gjon Milin. “Ç’është ky?”- u pyet. Ç’ka bërë? “Ku ka punuar? A e ka dashur Shqipërinë?...” Ç’bente gjatë Luftës?!...


-Atë që bënë tërë amerikanët. Megjithatë, Mili jonë, fotografonte të varfërit nën Statujën e Lirisë... Për revistën “Life”... -Qe thënia më kote që kam folur ndonjëherë. Sigurisht nga e papritura kësioj dhe përpjekja për ta “shpëtuar”... Një tis bezdie nisi ta shtynte entuziazmin drejt portës së inatit... Por, s’u zgjat.

-Ama në “Life” ka punuar? Mbylle atë muhabet... edhe për Terezën... Borxh s’u kemi. Në shtypin tonë asgjë s’është shkruar ndonjëherë dhe, ne vjelim arritjet e shkencës shqiptare...

“Greku” A.H. me luajti syrin. Unë heshta. Dhe u mbyll. Dy shqiptarët e mëdhenj, Nënë Tereza dhe Gjon Mili, mbetën jashtë faqeve të FESH. Mbetën jashtë edhe plot të tjerë... Me më kryesorin Mehmet Shehu, kryeministrin më detyrëgjatë në këtë truall, që qe vrarë



Gj. Mili: Pikaso dhe vizatimi në ajër - 1949



apo vetvrrarë, nja një vit e ca më parë. Përkundër nisën të shtoheshin të tjerë gjatë botimit - me prapaktheu plot telashe të zorshme... - figura hiç... që, së pari po i dëgjoja: V. Çerava, Mine Guri, Petro Dode dhe... - ç'ta zgjasim, ngase është ngjarja më cingërrimë në tërë historinë rreptësisht të papërshkrueshme të mendësisë a situatës që ndërtoi së pari Monumentin e Kulturës Shqiptare: FESH-in (1985). Thellësisht në kohë do të mbetet aq më shumë Monument, tamam sepse, mbart mbi kurriz ç'ka duhej e s'duhej, mangësinë a plotësinë e tamam kësaj: ç'ka duhet e s'duhet...si në refleksionin e një pasqyre të rreptë. Qenë kohë trysnie "robotike" açisoj, për produktin e së cilës, shqiptarët e punës këtu (të ndërgjegjësuar ose jo), me shumë se me faj... kanë veçse merita...

Një nga fotografët më të mëdhenj të shekullit, Gjon Mili, ndërroi jetë në Stamford, në Connecticut, më 14 Shkurt 1984. Shërbesa fetare dhe homazhet u kryen në New York më 16 shkurt, aty ku Mili kaloi pjesën më të madhe të jetës së tij.

Ai i pati kryer studimet në *Institutin Teknologjik të Massachusetts*, MIT. Ku edhe u diplomua si inxhinier elektrik në 1927.

Menjëherë më pas u ngarkua nga *Westinghouse* për të bërë kërkime mbi dritën në laboratorët e tyre. Aty punoi nja 10 vjet.


Debutimin në karrierën si fotograf e pati më 1937, kur ai filloi të përdorte shkencërisht flashin elektronik, për të shprehur lëvizjen. Shkurt: ndriçimin e fragmentuar të lëvizjes në sfondin e terrshëm... - shpikur nga miku i tij Harold Edgerton.

Gjon Mili u bë shpejt i njohur dhe u vlerësua me të gjitha meritat në SHBA, ku ai punonte dhe jetonte. Mili, bashkë me familjen, iku pesë vjeç në Rumani. Mori aty shkollimet e mesme. Iku 9 vjeç në Amerikë, mbaroi shkollimet e larta dhe u punësua atje. Fill mbas Luftës së viteve dyzet (1946), Mili kërkoi të vinte në Shqipërinë e dashur por, edhe herë të tjera, prap nuk u lejua. Arsyeja "e heshtur" le të themi se qe - ngase punonte në shtypin Amerikan...

Gjon Mili lindi më 1904 (28 Nëntor) në Korçën shqiptare, kujtimeve për të cilën, i qëndroi besnik.

"Fotografia", thoshte Mili, "jo domosdoshmërisht duhet të të ftojë të reflektosh, por duhet të shokojë spektatorin dhe ta "ndërsejë" të perceptojë anomalinë e arratisjes"...

E thëna e Heraklitit: "gjithçka është dhe s'është, gjithçka është fluide, paprerë në ndryshim, ç'do gjë ekziston dhe zhduket vazhdimisht..." hyri thellë brendësisë së Milit, qysh herët, në vitet mbasuniversitare. Atëherë kur Mili e pat gjetur rrugëzimin e jetës: Fotografia. Mbaroi në *Massachusetts Institute of Technology*, për elektrike, më 1927. Dhe për dhjetë vjet (deri më 1937), qe inxhinier ndriçimi në *Westinghouse Corporation* në Cambridge. Punoi tamam në kontruktimin e fijeve të llampave për projektim. U arrit sinkronizimi i fotografimit deri në 1/250 e sekondës me flash-llampat e ndërtuara nga fije alumini (zbuluar në Gjermani më 1931). Por Mili kërkonte më shumë. Ekzistenca dhe zhdukja i ndodhin kësaj jete pambarimisht në thërmijë. Si mund të "ndalet" një predhë topi, pushke...? Si mund të copëzohej e "vilej" lëvizja e padukshme e një objekti? Dhe shansi erdhi.



Gj. Mili dhe macja e tij Blackie, New York, 1946

Bashkëpunimi me Harold Edgerton. Që mundësuan 1/100.000 e sekondës. Lindi kështu fotografimi artificial i ashtuquajtur stroboscopic. Që lypse tashmë vetëm imagjinatë. Meritën për të cilën e plotpushton Mili. Me valltaren e "copëzuar" deri në "pakuptim". Me predhën e "ngrirë" në grykë të topit. Me... 1937: balerina e shkathët B.Fridman u fut në kurthin e eksponimit të shumëfishtë. «Life» e Nju-Jorkut ndërroi pamjen. Habiti lexonjësit. I mbërtheu në kureshtje: mendim të thellë dhe tisin e humortë që rrezonte emocioni i copëzimit të lëvizjes a energjisë njerëzore brenda një kuadrati. Kjo "përkundje" në hapësirë, kjo ngulje njëkohësisht e pjesëzës së lëvizjes, theu plotësisht ligjet e kohës dhe gravitacionit. "Life" shtoi famën dhe të famshëm e bëri edhe Milin. Që nisi udhët e Botës. Në vende, popujt, njerëz... Të thjeshtë e të njohur. Artistë, politikanë, shkencëtarë. Në ngjarje të mëdha të Botës: në qendra kulturore, sporti, politike, arti. "Shqiptari gjenial", shkeli Botën, e fiksoi atë me mund dhe mend dhe zuri vend edhe në të gjitha librat shkollorë të edukatës artistike si mjeshtri i "çastit të llogaritur". Veçse jo në librat shqiptare. Aspak për arsyen e thjeshtë dhe të çuditshme: që edhe s'pati arsye.

Kur vërejmë se një kuadrat fotografik mbart brenda vetes sharmin që të përnxit... ndër të tjera themi edhe: "ky fotograf paska sy..." Dhe, meqë punët fotografike që vërtetë përnxisin, e thëna "paska sy..." adresuar Gjon Milit, duket e mangut... Përse? Ngase, parësore në imazhet e Milit, mbetet ngulitëse vlere e "syrit të shpirtit..." Që është një shkallëzim majëlart, tutje nga "syri vëzhgues..."

Harold Edgerton e shpiku përpjestimin nënsekondësh të komandimit të dritës, - e ashtuquajtur stroboscopice... Gjon Mili e aplikoi... E përjetësoi dashurueshëm. Shpikësi mbeti më mbrapa... Pikëvështrimi mbetet përherë relatë vlerësuese. E bën domethënëse një vepër arti. Ka rëndësinë e vet "syu vëzhgues". E thotë me të drejtë Sartri, se Mili është "njeriu kurth"... Diçka që mund të thuhet edhe për nënsekondin e lëvizjes. Të rrokësh gjatshëm shprehinë e lëvizjes përballë, mbetet kapje "breshëri" edhe e "syrit vëzhgues"... Por, një vepër arti në fotografi, lyp edhe të tjera ndjesi... - komplekse - sukseseve... - për ta cilësuar autorin në shkallëzimet e artistit dhe personalitetit...

Gjon Mili ka "grackë" edhe "syrin e shpirtit..." "Syri i shpirtit" i artistit fotograf plotzotëron "Grepin grackë..." "Syri i shpirtit" vështron tensionueshëm plot-hapësirën e imazhit... me gishtin në shinjestër godet çastin më të ngopshëm. Ndjerë së brendshmi, munda finalizon arritjen. Në grimcëkohën që kërkohet me nge, imazhi bie në grackë mëvetishëm. Ka një "thirrje" të çlirisë së objektit, ka një goditje aspak trembëse, ka një puqie që e rrok pamjen plot jetësi... Mbetet një ndalje fryme si dëshmi... ai gllabërim i imazhit - një mëvete zotërimi ai nënsekondësh i goditjes... Mbetet vepra që ndjeson art... Grimcëkohë fiksohet, ndalet ç'kapet... më nuk ikën - mbetet monument... lind kështu, imazhi i ndjeshëm, i ngopur me art... "Grepin grackë" ka plotzotëruar dhe përjetsuar hapësirën artistike... - e ka siguruar pavdekshëm me kyçin e artë... "Syri i shpirtit" së fundmi "rehatohet"... vëzhgon e pret në heshtje për të mbledhur opinion... Pra, kështu, imazhi i ndiejës, natyrshëm "kreket" përballë gjykimit të ardhmë...

A ka imazh nga ç'na la Gjon Mili, që të mos krenohet përpara syve tanë?!

PËRSE TOLSTOI E URRENTE SEKSIN?

nga Alexandra Guzeva
(Russia Beyond)



Lev Tolstoy në 1856

Predikues i moralitetit nga njera anë, admirues zjarrtë i grave nga ana tjetër... Si mund të bashkoheshin të dyja te shkrimtari rus më pjellori në të gjitha kuptimet e fjalës?

Tolstoy është një personazh unikal dhe kontradiktor. Në biografinë e tij, dhjetra intriga dhe histori dashurie fqinjërojnë me predikime mbi moralitetin, dlijësinë dhe vlerat e familjes. Mos vallë është përpjekur që me moralizimet në veprat e tij të shlyejë mëkatet?

Turp dhe kurvërim

Të parën ndjenjë romantike dhe mishtore për një femër ai e provoi kur ishte afro trembëdhjetë vjeç. Ja çfarë ka shkruar në ditar: "Një ndjenjë të fortë, të ngjashme me dashurinë, kam provuar vetëm kur kam qenë trembëdhjetë apo katërmëdhjetë vjeç; por [nuk] dua ta besoj se kjo ishte dashuri; sepse objekti i saj ishte një shërbyese e ngjallur (e vërteta, me një fytyrë shumë të bukur), përveç kësaj, nga

trembëdhjetë deri pesëmbëdhjetë vjeç, është koha më e trazuar për një djalë (adoleshenca); nuk e di, se ku të kridhesh dhe epshi në këtë periudhë godet me një forcë të jashtëzakonshme."

Në të tetëmbëdhjetat, shkrimtari i ardhshëm nisi të mbajë ditar - në spital, ku vajti për një sëmundje veneriane. Ishte një tronditje e vërtetë për të dhe iu desh të fthillonte ndjenjat e tij. Megjithatë, edhe sëmundja nuk e ndaloi djaloshin në kërkim të dëfrimeve - ai shpesh shkruan për epshin dhe përsiatet mbi këtë temë.

Në vitin 1854, kur mori pjesë në luftën e Krimesë, korpusi i 26 vjeçarit Tolstoy kaloi ca kohë në Bukuresht. Me një hidhërim të dukshëm shënon përsëri në ditar, se si ai "u prish": "Kam pasur disa femra, gënjeja, hiqesha sqimatar, dhe ç'ishte më e tmerrshme, në luftime nuk isha ai sikundër kisha shpresuar se do të isha."

Dy vjet më vonë ai shkoi në çifligun e tij në Jasnaja Poljana, dhe, duke vuajtur nga limontia, shkruan se lëngonte prej dëshirave epshore të përditshme dhe e ndiente veten tmerrësisht

të ndyrë për këtë shkak. "E vendosa, kudo të ishte dhe sido të ishte këto dy muaj të gjeja një dashnore". "Epsh i tmerrshëm, që arrin deri në sëmundje fizike", "Sorollatem nëpër kopsht. Një fshatarkë shumë e bukur, një bukuri tepër e ëmbël. Jam padurueshëm i poshtër me këtë dëshirë të fshehtë të pafuqishme drejt vesit. Vesi do të kishte qenë më i mirë se unë."


Nga ditari i shkrimtarit mund të duket se Tolstoy ka qenë një feminist (gruar) i paparë dhe shumë studiues pikërisht kanë arritur në këtë përfundim, duke përhapur fjalë për një numër të madh fëmijësh, gjoja të ngjizur nga Tolstoy me fshatarkat (në fakt dihet vetëm për një fëmijë). Dhe megjithatë, një shthurje e tillë dhe vajtjet në shtëpinë publike për një djalosh-oborrtar të asaj kohe ishin diçka e zakonshme. Dhe ja sa tërbimshëm e qorton veten, sa shumë vëmendje i kushton, sa e përjeton - një rakurs krejtësisht krejtësisht i pazakonshëm.

Lufta me vesin

Tolstoy vazhdimisht e rishqyrton marrdhënien e tij me dashurinë mishtore dhe i vë vetes synimin se çfarë njeriu duhet të bëhet. Kështu, në vitin 1855 ai shkruan: "Njeriu në përgjithësi synon jetën shpirtërore dhe për të arritur qëllimet shpirtërore duhet ajo gjendje, në të cilën kënaqja e dëshirave mishtore nuk i kundërvihet, ose përputhet me kënaqjen e dëshirave shpirtërore... kështu, ja rregulli im i ri përveç atyre të cilët ia kam vënë vetes prej kohësh - të jem veprues, i arsyeshëm dhe modest".

Që ta mbyste vesin, Tolstoy vendos që të merret me diçka vazhdimisht. Nga viti 1856 ai kërkon aktivisht për grua dhe dëshiron t'i japë fund asaj mënyre jetese orgjish. Por me asnjë nga pretendentet-oborrtare nuk krijoi dot marrëdhënie. Vetëm pas gjashtë vjetësh, kur ai kishte mbushur tridhjetë e katër vjeç, ai do të takojë tetëmbëdhjetëvjeçaren Sofia Bers, e cila atij "iu përshtat"

Përpara dasmës ai përpiqet "të pastrojë ndërgjegjjen" dhe i tregon të fejuarës së tij të re ditarët e tij - dëshiron që midis tyre të mos kishte sekrete dhe i betohet se nuk do ta tradhëtojë. Aventurat, e përshkruara atje, e bënë Sofien të përloset jo pak. Megjithatë, ajo pranon të bëhet dasma dhe pas kurorëzimit Tolstoy e shpuri menjëherë në Jasnaja Poljana.



Lev Tolstoy në 1848, 20 vjeç

A ka lumturi në martesë?

Tolstoi jo vetëm i moralshëm, por sipas mënyrës së vet ai është i devotshëm. Besohet që ai ka qenë një tiran i vërtetë në shtëpi, duke e detyruar gruan të lindë njeri pas tjetrit trembëdhjetë fëmijë. Shkaku ishte i thjeshtë: ai “i trembej se mos e zemëronte zotin”. Është i njohur dhe një rast kur Sofia kishte një tumor malinj. Thërritën mjekun dhe ai i kërkoi leje burrit të saj për ta operuar. Por Tolstoi iu desh një kohë e gjatë për të marrë vendimin, duke besuar se “nuk mund t’i kundërvihesh vullnetit të zotit”, madje, edhe nëse gruaja mund të vdiste. Megjithatë, gruaja e donte, përkushtimi i saj ishte pakufi, drejtonte punët e tij (dhe punët e të gjithë Jasnaja Poljanas), duke u marrë me fëmijët, jetën e përditshme, disa herë kopjoi me dorë romanin “Lufta dhe Paqja”. Tolstoi besonte se fati i femrës është pikërisht në familje-siç ishte për shembull Natasha Rostova te “Lufta dhe Paqja”, e cila e gjente lumturinë tek fëmijët dhe Kiti Sherbatskaja tek “Anna Karenina”, që e shndërroi në amësi. Por ama të gjithë e kujtojnë se çfarë bëri Tolstoi me vetë Anna Kareninën, e cila kapërceu përmes familjes dhe u zhyt në pasion, duke harruar të birin.




Sophia Bers në 1862

Refuzimi i seksit

Në vitet 1880, Tolstoi përjetoi një përmbysje shpirtërore dhe ndryshoi krejtësisht pikëpamjen mbi botën. Për shembull, ai dëshironte që të hiqte

dorë krejtësisht nga prona private dhe të drejtat e autorit për veprat e tij. Po ashtu ndryshoi qasjen ndaj martesës. Në qoftë se familja në krijimtarinë e tij, ishte dikur vlera më e lartë, tashmë është absolutisht i deziluzionuar në martesë- mendimet e tij i mishëron në “Sonata e Krojcerit”.



Lev Tolstoi dhe gruaja e tij rreth 1906

Në novela ai flet për natyrën e poshtër të pasionit, sesi njeriu nuk mund të bëjë zap epshin apo për forcën shkatërrimtare të xhelozisë. Heroi kryesor, i cili në rininë e tij ka qenë lapërdhar (imoral), si vetë autori, thotë se femrat janë krijuar vetëm për të eksituar meshkujt. Prej xhelozisë ai vret gruan e tij të pafajshme.

Në këtë kohë, Tolstoi, jo vetëm është shkrimtari më i famshëm, por një lider i vërtetë shpirtëror. Çdo vepër të tij të re publiku e lexon me etje dhe kjo vepër ushtron një ndikim të madh. Prandaj “Sonata e Krojcerit” pas botimit u ndalua nga censura cariste. Studiuesi i Tolstoi, Pavel Basinskij shkruan: “Pasi lexojnë “Sonatën e Krojcerit”, të rinjtë hoqën dorë nga martesat dhe vazhdimësia e racës (brezit), duke u nisur nga ajo se në themel të familjes qëndron instinkti i ndyrë seksual.”

Kënaqësinë seksuale shkrimtari e koncepton tani jo si një gëzim të rinisë, por si një varësi serioze. “Kurvar nuk është një sharje, (mendoj po ashtu dhe kurvë) por një gjendje shqetësimi, kurioziteti dhe nevojë për risi, që rrjedhin nga lidhja për hir të kënaqësisë, jo me njërin por me shumë syresh. Si një pijanec ai mund të përmbahet, por pijaneci është pijanec dhe kurvari është kurvar, sapo ta humbë paksa vëmendjen ai do të bjerë”, shkruan ai në ditar. “Unë jam kurvar”,- vijon ai më tej.

Ndërkohë që po punonte mbi “Sonatën e Krojcerit”, Tolstoi merr broshura nga “The Shakers”, një organizatë fetare amerikane që predikonte beqarinë. Ai i shkruan mikut dhe botuesit të tij Vladimir Çertkov, se ata veçse ia kanë përforcuar pikëpamjen e tij për martesën. Tashmë ai predikon jo vetëm moralitetin dhe luftën me kurvërinë, por përgjithësisht dliresinë dhe beqarinë.

Në fund të jetës, Tolstoi vendos të çlirohet nga martesa — ikën prej gruas dhe në përgjithësi nga shtëpia. Dhjetë ditë më vonë do të vdesë në një stacion hekurudhor të një rajoni fqinj.

Përktheu Bujar Hudhri

Mbi historinë e palexuar dhe të ndryshuar të shtypshkronjës kineze dhe koreane me shkronja të lëvizshme

PRA, NË TË VËRTETË, NUK QENKA GUTENBERGU AI QË SHPIKU SHTYPSHKRONJËN

M. Sophia Newman

Nëse një libër do të cilësohej “i njohur botërisht si më i rëndësishmi nga të gjithë librat e shtypur”, cili prisni të jetë? Nëse do të ishte Margaret Leslie Davis, përgjigja do të ishte e qartë. Edhe libri i saj me titull “Gutenbergu i humbur: historia befasuese e Odisesë pesëqind vjeçare të një libri”, botuar në mars 2017, fillon pikërisht me këtë cilësor. Libri rrëfen sagën e kopjes së vetme të Biblës së Gutenbergut, njëres nga disa kopjet e mbijetuara të Biblës 450 vjeçare, shtypur nga Johan Gutenbergun (Johannes Gutenberg), shpikësi i hamendësuar i shtypshkronjës, një nga projektet e tij më të hershme, kopje të cilat rrugëtuan gjatë shekullit të 20-të pasi u shitën, u zotëruan nga koleksionistët, bibliotekat dhe arkivat.

Davis citon Mark Tuenin (Mark Twain), i cili në 1900 shkroi, një letër me rastin e hapjes së “Muzeut Gutenberg”. Për Davis-in, fjalët e Tuenit ishin “shumë me vend.” “Çfarë është bota sot,” shkroi Tuein, “me të mirën dhe të keqen, ia detyron Gutenbergut. Gjithçka e ka zanafillën tek ky burim...” Në të vërtetë, risia e Gutenbergut është parë për një kohë të gjatë si pikë kthese në historinë njerëzore, risi e cila shtroi rrugën për Reformën Protestante, Rilindjen, revolucionin shkencor, përhapjen në masë të arsimit, dhe mijëra ndryshime të tjera që prekin thuajse çdo gjë që njohim sot. Ky është i vetmi problem?

Pohimi i përbotshëm bërë më lart, në të vërtetë, nuk është edhe aq i përbotshëm, dhe Gutenbergu vetë është vetëm njëri nga burimet e shtypshkrimit dhe jo burimi i vetëm. E vërteta është se risitë themelore në atë që

do të përbënte ndryshimin rrënjësor në teknologjinë e shtypshkrimit nisën në Azinë lindore, me punën e bërë nga fisnikët e dinastive kineze, budistët korean, dhe pasardhësit e Xhengis Khanit, dhe, kjo është një vërtetë të cilën Davis e pranon me fare pak fjalë, ndërkohë që puna e tyre filloi disa shekuj para se të lindte Gutenbergu.

Në një shtypshkronjë tradicionale, pllakëza të vogla metalike me shkronja të krijuara në anën e prapme, të njohura si shkronja të lëvizshme, përshtateshin në një kallëp të mbuluar me bojë, i cili vendosej në një copë letre. Pas heqjes së letres, mbetej faqja e shtypur. Ky proces përsëritej aq herë sa faqe kishte libri, për të patur një libër të shtypur. Dhe nëse kjo përsëritej edhe me librin, libri shtypej shpejt dhe në shumë kopje.

*

Shtypshkronja shpesh thuhet se është krijuar nga Gutenbergu në Mainz, Gjermani, rreth viti 1440 pas Krishtit, dhe filloi të zërë rrënjë në Evropë në vitin 1450 me shtypjen e Biblës së lartpërmendur. Vetë librat kishin qenë të pranishëm në Evropë shumë kohë më parë, natyrisht, por vetëm vëllimet e kopjuara me dorë, të cilat në pjesën më të madhe binin në duart e pjesëtarëve të klerit. Qasja ndaj librave të prodhuar në masë ndryshoi rrënjësisht në fund të viteve 1400, me përhapjen e shkrimit dhe leximit duke e ndryshuar fenë, politikën, dhe stilin e jetës në të gjithë botën.

Së paku, kjo është historia që tregohet në shumicën e

librave, duke përfshirë, në pjesën më të madhe të librit, “Gutenbergu i humbur”. Por një fjalë e vetme nga fundi i librit tregon për një histori më të gjatë: “Shkronjat e lëvizshme ishin shpikje kineze e shekullit të 11-të, e çuar më tej në Korenë e vitit 1230, para se në Evropë të krijoheshin rrethanat në kohën e Gutenbergut që të lulëzonte shtypshkrimi”. Kjo fjalë minimizon dhe paraqet në mënyrë të gabuar çfarë ka ndodhur.

Hapat e para të zhvillimit të shtypshkrimit filluan afërsisht 800 pas Krishtit, në Kinë, ku teknikat e hershme të shtypshkrimit përfshinin krijimin e një faqeje tekti të plotë në një kallëp druri, me bojë, duke shtypur faqet në kallëpin e drurit. Rreth vitit 971 pas Krishtit, në Zhejiang, Kinë, u prodhuan një makinë shtypi e standartit budist e quajtur “Tripitaka” me këto kallëpe druri të gdhendura, duke përdorur 130.000 kallëpe (një në secilën faqe). Përpjekjet e mëvonshme do të krijonin lloje të mëhershme të shkronjave të lëvizshme duke përfshirë përdorimin e suksesshëm por të pamjaftueshëm të ideogrameve të gdhendura në dru dhe një përpjekje të shkurtër, të pafrytshme për të krijuar shkronja prej qeramike.

Ndërkohë, importet perandorake nga Kina i sollën këto risi për sundimtarët korean të quajtur Goryeo (emrin e të cilëve ka sot Korea), të cilët kishin rol vendimtar në hapat e mëpasmë të historisë së shtypshkrimit. Pjesa e tyre e historisë ka shumë shembuj risish gjatë pushtimit.

Së pari, në 1087 pas Krishtit, një grup nomadësh të quajtur Khitans u përpoqën të pushtonin gadishullin korean. Kjo bëri që qeveria Goryeo të krijojë Tripitakan e saj me shtypshkrim me kallëpe druri, ndoshta me qëllim ruajtjen e identitetit korean budist përballë pushtuesve. Përpjekja do të ishte largpamëse. Ajo ruajti konceptin dhe teknikën për vitet e mëvonshme, kur arritën shumë më shumë pushtues. Në shekullin e 12-të dhe 13-të, sundimtari Mongol, Xhengis Khan kishte krijuar perandorinë më të madhe në historinë njerëzore, e cila shtrihej nga Bregu i Paqësorit në Azi, drejt perëndimit deri në Persi. Pasi vdiq në 1227, pasardhësi i tij, Ögedei Khani, vazhdoi duke pushtuar territore që nuk i kishte pushtuar Xhengis Khani asnjëherë më parë. Në vitin 1231, Ögedei urdhëroi pushtimin e Koresë, dhe në 1232, trupat pushtuese mongole arritën në kryeqytet. Gjatë pushtimit, ata dogjën kopjen koreane të Tripitakas duke e bërë shkrumb e hi.

Dinastia Goryeo e rikrijoi menjëherë librin. Mendohet që të ketë qenë libër me “Lutje fuqisë së Budës për mbrojtjen e kombit nga mongolët pushtues”, siç shkruhet në një tekst të Thomas Christensen-it, por u bë edhe me qëllimin për ta ruajtur kulturën e



Gutenbergu dhe prototipi i makinës së tij të shtypit



dinastisë. Dhe kjo ishte e rëndësishme sepse sulmet nga mongolët do të vazhdonin edhe 28 vjet më pas.

Me ribërjen e Tripitakas ishte menduar të merreshin murgjit korean të cilët duhet ta përfundonin deri në vitin 1251 pas Krishtit, ndërkohë që sundimtarët filluan të shtypin libra të tjerë. Në vitin 1234 pas Krishtit, ata i kërkuar pastorit civil të quajtur Choe Yun-ui të shtyppte një libër budist me titull “Tekst këshillues i ritualeve për të kaluarën dhe të tashmen” (Sangjeong Gogyeum Yemun). Por ky libër i gjatë kërkonte një numër të madh kallëpesh druri, kështu që Choe propozoi një zgjidhje tjetër. Duke u mbështetur në përpjekjet e mëparshme kineze për të krijuar shkronja të lëvizshme, ai zbatoi një metodë që ishte përdorur gjatë prerjes së monedhave prej bronzit për të krijuar shkronja tri përmasore në metal. Pastaj këto pjesë i rregulloi në një kornizë, i mbuloi me bojë dhe i përdori për të shtypur fletë letre. Pas kësaj, ai mund të riorganizonte shkronjat metalike, duke hequr nevojën e nevojshme për kallëpe druri të gdhendura. Ishte proces deri diku më i shpejtë. Ai e përfundoi projektin në vitin 1250 pas Krishtit.

Është e rëndësishme ta pranojmë se çfarë do të thotë kjo. Risia që Gutenbergu thuhet se ka krijuar ishin kallëpe të vogla metalike me shkronja të ngjitura prapa, të rregulluara në një kornizë, të lyera me bojë dhe të shtypura në një copë letër, e cila lejonte që librat të shtypeshin më shpejt. Por Choe Yun-ui e bëri këtë para tij dhe ai e bëri 150 vjet para se të lindte Gutenbergu. Ndoshta duhet të jetë Choe Yun-ui, emri që duhet të mbajmë mend, jo ai i Gutenbergut.

Sidoqoftë, librat e shtypur të Koresë nuk u përhapën me shpejtësi, siç do të përhapeshin librat e Gutenbergut 200 vjet më vonë. Kjo ngaqë Koreja ishte e pushtuar, gjë që i pengoi ta përhapnin këtë risi të shpikur nga ata. Për më tepër, shkrimet koreane, të mbështetura më pas shumë tek kinezishtja, përdorën një numër të madh shkronjash të ndryshme, të cilat e bënë krijimin e pjesëve metalike dhe bashkimin e tyre në faqe, një proces të ngadaltë. Më e rëndësishmja, sundimtarët e Goryeo-s synuan që pjesa më e madhe e projekteve të shtypjes së librave të përdorej vetëm nga fisnikëria.

Megjithatë, ka mundësi që teknologjia e shtypjes së librave të jetë përhapur nga Lindja në Perëndim. Ögedei Khan, udhëheqësi mongol, kishte një djalë të quajtur Kublai i cili e kishte shpallur veten si sundimtar në Pekin. Kublai Khan kishte mundësi ta përdorte teknologjinë koreane dhe kineze të shtypjes së librave, dhe mund t’ia ketë përcjellur këtë njohuri nipit tjetër të Xhengis Khanit, Hulegu-t, i cili në atë kohë sundonte pjesën perse të perandorisë mongole. Kjo mund ta ketë zhvendosur me mijëra milje teknologjinë e shtypjes së librit nga Azia Lindore në perëndim. “Mongolët thjesht prireshin ta merrnin teknologjinë e tyre kudo ku shkonin, dhe ajo bëhej pjesë e kulturës lokale, nganjëherë e pranuar, nganjëherë jo”, shpjegon profesori historisë aziatike në universitet, Colgate David Robinson.

Për të kaluar nga Azia Lindore në Persi asokohe

udhëtohej përmes Rrugës së Mëndafshit. Në mes të asaj rruge shtrihej atdheu i popullit ujgur, një grup etnik turk i rekrutuar në ushtrinë mongole shumë kohë më parë. “Nëse kishte ndonjë lidhje me përhapjen e shtypjes së librave midis Azisë dhe Perëndimit”, shkroi studiuesi Tsien Tsuen-Hsien në librin “Shkenca dhe qytetërimi në Kinë në vitin 1985, “ujgurët që përdorën si shtypjen dhe shkronjat e lëvizshme kishin mundësi të mira për të luajtur një rol të rëndësishëm në këtë proces”.

Kjo pasi, në shekullin e 13-të, ujgurët shiheshin si njerëz të dalluar, të kënduar, nga ata për të cilët shtypshkrimi mund të ishte një risi e mirëseardhur. Ata kishin gjithashtu diçka të cilën askush tjetër nuk e kishte pasur deri atëherë: një alfabet, një grup i thjeshtë me deri diku pak shkronja për të shkruar çdo fjalë që dëshiroje të thoshe.

Në perandorinë perëndimore mongole nuk pati lulëzim të shtypshkrimit. “Nuk kishte treg, nuk kishte nevojë që udhëheqësit të komunikonin me nënshtetasit nëpërmjet librit, nuk kishte nevojë të mblidhej ose investohej kapital në një industri të re”, thekson historiani John Man në librin e tij, “Revolucioni Gutenberg”. Megjithatë, shtypshkronjat me shkronja të lëvizshme të ujgurëve, u zbuluan në këtë hapësirë dhe janë tregues se teknologjia është përdorur atje.

Për më tepër, mongolët mund ta kenë kaluar teknologjinë jo vetëm përmes ujgurëve dhe territorit persian, por edhe në Evropë, duke përfshirë Gjermaninë. Perandoria mongole e pushtoi Evropën rreth viteve 1000 deri në 1500 pas Krishtit. Ajo periudhë shënoi hyrjen e mjaft ushtarëve dhe robërve të Azisë Perëndimore duke u bërë shkak për futjen e shumë fjalëve nga gjuhët turke në ato evropiane. “Në përgjithësi, nëse diçka kalon nga Azia Lindore [në perëndim], është e vështirë ta imagjinosh pa mongolët”, shprehet në një intervistë Christopher Atwood, profesor në universitetin Indiana (Indiana University) për Euro Azinë Qendrore.

Ideja fantastike që vetëm Gutenbergu e shpiku shtypshkronjën shpërfill një kontinent të tërë dhe përpjekjet e bëra për disa shekuj. Përfundimisht, kapitalistët e hershëm në Evropë investuan në sipërmarrjen e biznesit të Gutenbergut, i cili kombinoi teknologjinë e njëllojtë me të shkronjave të lëvizshme të zbuluara nga Choe Yun-ui, me një mekanizëm spiral që shtrëngohet me vida njësoj si ai që përdoret për të prodhuar vajin e ullirit dhe verën, duke i dhënë shtypshkrimin shpejtësinë që kërkonte tregu. Gutenbergut iu deshën dekada derisa kjo nismë të jetësohej, më pas u detyrua të falimentonte dhe kjo çoi në procese gjyqësore me investitorët të cilët e paditën për t’u kthyer paratë. Siç vëren Davis në “Gutenbergu i humbur”, nga këto dëshmi e njohim Gutenbergun dhe Biblën e tij: “Origjinën e librit më të famshëm e njohim pak. Historitë që tregojmë për njeriun dhe si u shtyp Bibla, janë krijuar mbështetur në disa dokumente ligjore dhe financiare, dhe për shekuj me radhë

stduimet kanë plotësuar vetë zbrazëtinë çfarë mungon”.

Në të vërtetë, e gjithë historia e shtypshkronjës është plot me zbrazëti. Gutenbergu nuk e tregoi historinë e tij për librat e shtypura në shtypshkronjën që krijoi, arritjen më të mirë të njohurive modern. Ai nuk la asnjë shënim për punën e tij. Dhe nëse Gutenbergu la pas heshtjen, mongolët, bashkatdhetarët e tyre ujgur dhe krerët e qeverisë së Azisë Lindore e bënë këtë edhe më shumë.

Por nëse dyshimet janë të natyrshme, atëherë rezultati që kemi prej tyre nuk është. Ideja fantastike që vetëm Gutenbergu e shpiku shtypshkronjën shpërfill një kontinent të tërë dhe disa shekuj përpjekjesh të rëndësishme dhe nuk bën asnjë përpjekje për të kuptuar se si ose pse teknologjia mund të ishte përhapur më parë. Në një studim të teknikave të krijimit të shkronjave nga Gutenbergu, programuesi kompjuterik Blaise Ag yera y Arcas theksoi se sa e çuditshme është kjo: “Ideja që një teknologji shfaqet plotësisht e përfunduar që në fillim është mashtrim. Kushdo që merret me teknologjinë e di se teknologjia nuk funksionon kështu”.

Davis, ka meritën se thekson të njëjtën gjë, duke e shpjeguar: “Ndoshta imazhi i Gutenbergut si gjeni i vetmuar i cili e shndërroi kulturën njerëzore është tërheqës sepse ndryshimi ishte kaq i jashtëzakonshëm sa ngjan gati mitik dhe i duhet një histori të tillë origjine për të përkuar me të”.

Por Davis, e cila nuk ishte e gatshme të intervistohet për këtë artikull, bën shumë pak për ta korrigjuar këtë të vërtetë tek “Gutenbergu i humbur”. Ajo e përmend Kinën vetëm disa herë dhe Korenë vetëm një herë dhe nuk përmend fare mongolët, ujgurët dhe aspektet jo-të krishtera të historisë së shtypshkrimit. Në të vërtetë, ajo nuk e shpjegon fare se Bibla e Gutenbergut nuk pranohet në të gjithë botën si libri më i rëndësishëm në histori. Ashtu si nuk shpjegon se nuk janë kopjet e Biblës librat më të vjetër të krijuar me shkronjat e lëvizshme që ekzistojnë edhe sot - megjithëse lexuesit mund t’i krijohet kjo përshtypje nga “Gutenbergu i humbur”.

Përkundrazi, libri më i hershëm i shtypur me shkronja të lëvizshme është libri me autor korean *Baegun Hwasang Chorok Buljo Jikji Simche Yojeo* (“Antologjia e mësimave Zen të priftërinjve të mëdhenj budist”). Ajo daton në vitin 1377 dhe ka shërbyer si pikënisje e studimeve për origjinën e shtypshkrimit me shkronja të lëvizshme.

Koreja e sheh këtë libër dhe vëllimet e tjera antike si pjesë e krenarisë kombëtare sepse ato renditen ndër librat më të rëndësishëm. Por vetëm kohët e fundit, kryesisht në dekadën e fundit, pikëpamja e tyre dhe fakti që aziatikët krijuan teknologji shtypi shumë më herët kanë filluar të pranohen. Shumica e autorëve që e pranojnë përfshin edhe Davis-in, e cila nuk pranoi të intervistohet me arsytimin, “Kam frikë se s’kam çfarë të them tjetër për temën e shtypshkrimit në kohëra të lashta” – ashtu si autorët e tjerë, ende nuk e di historinë e plotë.

Përktheu Granit Zela



TË SHESËSH GJITHÇKA

BESTSELLER NDËRKOMBËTAR

JEFF BEZOS DHE EPOKA E AMAZON

BRAD STONE

Minerva

LIBRI I BIZNESIT
I VITIT NGA
FINANCIAL TIMES
DHE *GOLDMAN SACHS*

Stone e rrëfen këtë histori me autoritet, entuziazëm dhe përshkrime të detajuara....

Një portret dinamik i Bezos-it ambicioz dhe kërkues". - *New York Times*